

SHKELJET LIGJORE QË PO SHTERIN LUMENJ



KOSID

KOSOVO CIVIL SOCIETY CONSORTIUM FOR
SUSTAINABLE DEVELOPMENT

KONSORCIUMI KOSOVAR I SHQËRISË CIVILE PËR
ZHVILLIM TË QENDRUESHËM

Nëntor, 2020

KOSID

KOSOVO CIVIL SOCIETY CONSORTIUM FOR
SUSTAINABLE DEVELOPMENT

KONSORCIUMI KOSOVAR I SHQËRISË CIVILE PËR
ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



SHKELJET LIGJORE QË PO SHTERIN LUMENJ

Nëntor, 2020

PËRMBAJTJA

| | |
|---|-----------|
| SHKURTESAT | 4 |
| HYRJE | 5 |
| I. ZHVILLIMET AKTUALE MBI NDËRTIMIN DHE FUNKSIONIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË | 6 |
| II. SHKELJET LIGJORE ME RASTIN E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË | 13 |
| III. TË DREJTAT E KOMUNITETIT NË BASHKË-VENDIMARRJE PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË | 25 |
| IV. REALIZIMI I TË DREJTAVE LIGJORE TË KOMUNITIT NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TYRE DHE MBROJTJEN E MJEDISIT | 27 |
| V. KORNIZA LIGJORE PËR HIDROCENTRALET NË KOSOVË | 29 |
| VI. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE MBI NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË | 32 |
| VII. PËRFUNDIME | 35 |
| VIII. REKOMANDIME | 38 |
| IX. SHTOJCAT | 41 |
| SHTOJCA I. LISTA E LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE TË LËSHUARA NGA ZRRE PËR HIDROCENTRALET NË KOSOVË | 41 |
| SHTOJCA II. - DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FUNKSIONIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË | 45 |

- SHKURTESAT -

| | |
|--------------|--|
| AMMK | Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës |
| ARPL | Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore |
| BRE | Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë |
| HC | Hydrocentralet |
| HCV | Hydrocentralet e Vogla |
| IKU | Instituti i Kosovës për Ujëra |
| IKMN | Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës |
| KNMU | Këshilli Ndër Ministror për Ujëra |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| KOSTT | Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës |
| MSA | Marrëveshja e Stabilizim Asociimit |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MEA | Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit |
| MW | Mega Watt |
| OE | Operator Ekonomik |
| VNM | Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis |
| VSM | Vlerësimi Strategjik në Mjedis |
| ZK | Zona Kadastrale |
| ZRRE | Zyra e Rregullatorit për Energji |
| ZVM | Zonat e Veçanta të Mbrojtura |

- H Y R J E -

Ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, përkatësisht nga resurset ujore të vendit, siç janë hidrocentralet, është një dukuri realivisht e re në Republikën e Kosovës, por po zhvillohet shpejt. Në këtë drejtim, kërkesat e operatorëve ekonomikë për prodhimin e energjisë hidrike po rriten dhe paralel me këtë po rriten edhe shqetësimet e komunitetit që jeton pranë këtyre rrejdhave ujore. Në fakt, tash mund të themi që në Kosovë po lind një lëvizje autoktone për të mbrojtur resurset ujore të vendit, për t'i përdorur dhe menaxhuar mirëfilli ato si dhe për mbrojtjen e mjedisit sipas legjislacionit në fuqi.

Ndërtimi i hidrocentraleve, duke mos respektuar legjislacionin në fuqi, dokumentet dhe planifikimet strategjike të vendit, si dhe ndërhyrja në shfrytëzimin e resurseve ujore në mënyrë jo të duhur nga operatorë jolegjitimë, ka degraduar resurset ujore që posedon Kosova. Fillimisht, këto veprime kanë shkaktuar zvogëlimin apo edhe ndalimin e plotë të qasjes së qytetarëve në përdorimin e resurseve ujore dhe në tharjen e tokave bujqësore të cilat gjenden pranë këtyre rrjedhave në të cilat ndërtohen ato hidrocentrale. Poashtu, kanë zvogëluar sasinë e resurseve ujore për përdorim të përgjithshëm, kanë shkaktuar ndryshimin dhe dëmtimin e ekosistemeve në rajonet ku ndërtohen ato, dëmtimin e peisazheve natyrore, dëmtimin e zonave të mbrojtura të vendit dhe ato me interes strategjik për vendin, si dhe dëmtimin e turizmit natyror të Kosovës. Në fakt, në shumicën e rasteve, ndërtimi i hidrocentraleve ka ndikuar në çrregullimin e tërësishëm të jetës së qytetarëve, natyrës dhe ekosistemit në këto rajone në tërësi.


Kjo analizë ligjore mbi hidrocentralet në Kosovë synon t'i zbardh këto parregullësi të bëra nga personat fizikë e juridikë nga sektori privat e publik. Këto shkelje janë bërë nga investitorë, duke ndërhyrë në përdorimin e këtyre resurseve ujore pa leje/autorizime ligjore apo duke mos i respektuar kërkesat dhe kriteret që rrjedhin nga ato. Ky raport identifikon shkelje të bëra nga vetë institucionet e Republikës së Kosovës me rastin e mos-ndërhyrjes në parandalimin e ndërtimit të hidrocentraleve, përmes lëshimit të dokumenteve publike të cilat nuk reflektojnë zbatimin e mirëfilltë të legjislacionit në fuqi, me të cilat ata i kanë pajisur këta operatorë për operimin e tyre.

Me këtë raport, KOSID ka bërë: 1. Një përmbledhje mbi zhvillimet aktuale mbi ndërtimin dhe funksionimin e hidrocentraleve në Kosovë; 2. Analizën e shkeljeve ligjore me rastin e ndërtimit të hidrocentraleve në Kosovë në mos-respektim të drejtave të komunitetit; 3. Një përmbledhje të kornizës ligjore të vendit që rregullon fushëveprimtarinë e hidrocentraleve; 4. Një përmbledhje të e kornizës institucionale në vend; 5. Një përmbledhje të udhëzimeve të kornizës ligjore që mund të shërbejnë për komunitetin në realizimin e të drejtave të tyre, përmes procedurave ligjore, si dhe 6. Rekomandimet konkrete për institucionet publike të vendit dhe palët e interesit në veprimet ligjore që mund të ndërmerren për situatën e krijuar dhe rekomandimet për plotësim-ndryshimin e legjislacionit përkatës dhe përmirësimin e masave zbatuese të tij.

Në fund, KOSID ka kontaktuar të gjitha institucionet e Kosovës që janë përgjegjëse për leje dhe strategjitë ujore për të kërkuar koment në gjitha shkeljet e evidentuara në këtë analizë. Asnjë prej këtyre institucioneve: Ministra e Mjedisit, Këshilli Ndërmnistror për Ujëra dhe Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk kanë komentuar në këto shkelje. Pra deri në botimin e këtij publikimi, asnjë prej institucioneve nuk i ka mohuar këto shkelje kur u është dhënë rasti të deklarohen.

I. ZHVILLIMET AKTUALE MBI NDËRTIMIN DHE FUNKSIONIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË

Kjo analizë bazohet në të dhëna e Republikës së Kosovës¹, ku hidrografia e rrjedhave ujore të Kosovës ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Rrjedhat lumore të Kosovës derdhen në tre ujëmbledhës detarë përfshirë Detin e Zi, Detin Adriatik dhe Detin Egje. Lumenjtë kryesorë të cilët i përkasin ujëmbledhësit të Detit të Zi janë: Ibri, Sitnica me degët; (Llapi, Drenica), dhe Morava e Binçës. Ndërsa, Detit Adriatik i përkasin: Drini i Bardhë me degët (Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, Lumëbardhi i Prizrenit, Lumi i Klinës, Ereniku, Mirusha, Toplluha dhe Plava). Kurse lumi i Lepencit me degën kryesore (Nerodime) i përket Detit Egje. Vija ujëndarëset (pellgjet ujëmbledhëse) kanë rrjedhje në drejtime të ndryshme. Koeficienti rrjedhës sillet prej 3.93 l/sec/km² (Morava e Binçës) deri 42.46 l/sec/km² (Lumëbardhi i Deçanit). Veçori e tyre është Drini i Bardhë ka gjatësisë më të madhe në kilometra brenda territorit të Kosovës me 122 km, ndërsa Lumëbardhi i Prizrenit më të vogël me 31 km.



Harta - Pellgjet dhe lumenjtë e Kosovës²

1. Shih: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Resurset_ujore_te_Kosoves.pdf

2. Burimi: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Resurset_ujore_te_Kosoves.pdf

Të dhënat e tre viteve të fundit 2018-2020 të publikuara nga ZRRE³ tregojnë se ndërtimi i hidrocentraleve nga ana e investorëve privatë ka shënuar rritje. Përveç të një përjashtimi⁴, ZRRE është duke vazhduar me lëshimin e autorizimeve finale për kryerjen e punëve për ndërtimin e HC, si dhe lëshimin e licencave për prodhimin e energjisë elektrike për aplikimet e pranuar deri më 4 qershor 2019, të përshkruara në Aneks I.

Sipas këtyre të dhënave janë vënë në operim **4 HC** me fuqi **34.04 MW**. **15 HC** tjera që janë duke finalizuar punimet e ndërtimit të tyre planifikohet të prodhojnë **44.023 MW**. Si dhe, në fazën fillestare të ndërtimit janë **4 HC** që planifikohet të prodhojnë **10.16 MW**.

Në saje të planifikimeve qeveritare sipas **Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë**, është e paraparë që **caku i energjisë së ripërtërishme në vitin 2020 të jetë 25%⁵ apo 240 MW e konsumit të gjithmbarshëm bruto të energjisë në vitin 2020 të mbulohet nga energjia hidrike⁶**. Ndërsa, **caku indikativ i energjisë nga burimet e ripërtërishme për vitin 2020 është 29.89% e konsumit përfundimtar bruto të energjisë⁷**, që ka shkuar përtej synimeve të përshkruara në ligj.⁸

Por, situata reale qëndron ndryshe prej këtyre planifikimeve. Sipas Bilancit Vjetor të Energjisë Elektrike dhe Termike për vitin 2020 të ZRRE-së⁹, prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga HC, të kyçura në sistemin e shpërndarjes në total është 202 MW (HC Ujmani 97 MW dhe HC-Kaskada e Lumbardhit 105 MW) apo **84% është përmbushur caku i përcaktuar dhe 16% nuk është arritur caku i përcaktuar për prodhimin e energjisë elektrike nga energjia hidrike¹⁰**. Pra, **nuk është arritur caku i synuar qeveritar prej 240 MW, ngase kapacitetet aktuale të prodhimit të energjisë elektrike nga HC ofrojnë 38 MW më pak**.

Keqtrajtimin dhe keqpërdorimin e resurseve ujore e ka mundësuar dhe përkeqësuar procesi i dhënies së lejeve ujore për OE bazuar në **Vendimin e Këshillit Ndër-ministror për Ujëra për lëshimin e lejeve ujore për ndërtimin e HC¹¹**. Por, me ardhjen e qeverisë së re, së fundi është themeluar Këshilli i ri Ndër-ministror për Ujërat.¹²

Së pari, është anashkalluar në tërësi zbatimi i **Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës**, i cili kërkon që përdorimi i resurseve ujore për qëllime ekonomike të prodhimit të energjisë elektrike të bëhet vetëm me koncesion¹³. Këtu, Qeveria ka marrë vendim në kundërshtim me këtë ligj, duke e mënjeluar në tërësi zbatimin e procedurave të konkursit publik për vënien në përdorim të resurseve ujore përmes koncesionit për prodhimin e energjisë elektrike për Operator Ekonomik, OE. Poashtu, kanë shpërdorur detyrën zyrtare përmes veprimit përtej autorizimeve dhe kompetencave ligjore të tyre, duke i mundësuar vetë Qeverisë të lëshojë leje ujore sipas këtij vendimi, citim *“Përderisa nuk krijohet kuadri ligjor për*

3. Shih Aneks I - Të dhënat janë mbledhura nga kërkimi individual i secilit aplikues, pasi që regjistri i publikuar nga ZREE nuk përfshin përditësimet e fundit mbi lëshimin e këtyre dokumenteve, deri më 09.09.2020, shih: <https://www.ero-ks.org/zrre/sq/legjislacioni/vendimet>

4. Vendimi i ZRRE Dt. për mos vazhdimin e lejes për operim për kompaninë Kelkos i marrë me

5. Neni 15 i Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12689>

6. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026, Mars 2017, Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, fq. 16, shih: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energjisë_2017-26_.pdf

7. Udhëzimi Administrativ MZHE Nr.05/2017 për Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, Neni 3, para 1, pika. 1, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14893>

8. Udhëzimi Administrativ MZHE Nr.05/2017 për Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme, Neni 3, para 1, pika. 3, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14893>

9. Shih: <http://ero-ks.org/2020/Sektoret/Bilanci%20Vjetor%20i%20Energjisë%20Elektrike%20dhe%20Termike%20per%20vitin%202020.pdf>

10. Këtu përfshihen të gjitha HC që janë funksionale, ato të trajtuara në këtë analizë dhe HC paraprake.

11. Vendim Nr. KNMU/V/02/2017, datë 10.01.2018, shih: https://kallxo.com/wp-content/uploads/2019/10/KNMU_vendimet2-2.pdf

12. Vendimi i Qeverisë Nr. 07/31, datë 21.09.2020 për themeleimin e Këshillit Ndër-Nministror për Ujërat, i përbërë nga Kryeministri i Kosovës, Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Ministri i Buqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrja e Financave, si dhe Ministri i Shëndetësisë, shih: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/10/Vendimet-e-mbledhjes-s%C3%AB-31-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>

13. Neni 78 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

dhënien e koncesioneve për shfrytëzimin e ujërave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor obligohet të zbatojë procesin e lejeve ujore”¹⁴. Pra, është pranuar në vendim se, për shfrytëzimin e ujërave, duhet zbatuar mënyra e rregullt përmes procedurave të koncesionit, por se me vendim të Qeverisë është shkelur kjo¹⁵.

Së dyti, ky vendim përcakton që MMPH të “zbatojë procesin e dhënies së lejeve ujore duke marrë parasysh dokumente planifikuese për menaxhimin e resurseve ujore (si Baza Hidroekonomike të Kosovës, e vitit 1983)”, i cili është vlerësim i vjetërsuar, si dhe i njejtë nuk përkon me gjendjen aktuale të resurseve ujore në vend.

Për më shumë mbi gjendjen aktuale mbi ujërat në Kosovë, sipas raportit të Bankës Botërore¹⁶ mbi vlerësimin e sigurisë së ujërave të Kosovës, rezulton se Kosova në përgjithësi përballet me:

- a) stres të ujit me nivelin më të ulët të resurseve ujore të zhvilluara me infrastrukturë;
- b) institucione të reja dhe jo shumë efektive për zbatimin e çështjeve kritike të (cilësisë së) ujit; dhe
- c) pritje të normalizimit të marrëdhënieve në lidhje me atë që është një nga burimet kryesore të ujit dhe shtrihet në veri të vendit.”

Poashtu, ky raport thekson së “...ujërat e Kosovës shpërndahen në mënyrë të pabarabartë në kohë dhe në hapësirë. **Pritet se në 20 vitet e ardhshme të gjitha pellgjet e Kosovës do të përballen me stres të ujit.**” ku si pasojë “Kosova është gjithnjë e më e ndjeshme ndaj përmbajtjeve dhe thatësirave, dhe që të dyja mund të kenë ndikime të thella mbi popullin dhe ekonominë. Me rritjen e stresit të ujit, cilësia e ujit do të bëhet problem gjithnjë e më rritje nëse nuk adresohet në burimet e saj të shumta (amvisëri, industri, bujqësi dhe nga degradimi i ujëmbledhësve)”. Në këtë drejtim, “...Kosova ka kornizë, strategji dhe koordinim adekuat të nivelit të lartë dhe ka nevojë që ta zhvendosë fokusin drejt zbatimit në terren të strategjive të saj, duke ndërtuar bazën për informacion, institucionet dhe infrastrukturën në menaxhimin e ujit me ndikime reale dhe rezultate të prekshme.”

Në këtë drejtim, mbi keqpërdorimin e resurseve ujore dhe ndërtimin e HC, shqetësimet dhe reagimet e qytetarëve/komunitetit të cilëve u janë cënuar të drejtat ligjore mbi resurset ujore dhe mbrojtjen e mjedisit, kryesisht lidhen me:

- Mospërfshirjen fare të komunitetit në debate, konsultime e njoftime publike me rastin e shqyrtimit të dokumenteve mbështetëse për lejimin e ndërtimit të hidrocentraleve;
- Mosinformimi në kohë apo pengimi në çasje për informacion për t’u përfshirë komuniteti për pjesëmarrje në konsultime publike;
- Mospërfshirje të komenteve, vërejtjeve dhe kërkesave për përmirësim të kriterëve dhe kushteve me rastin e lëshimit të akteve juridike (pëlqim, leje, licenca, etj) për ndërtimin e HC nga institucionet publike;
- Mospërkrahimi i drejtë i gjendjes reale të resurseve ujore dhe kushteve mjedisore me rastin e ndërtimit të HC-ve, si dhe ndikimi i tyre në ndotjen, degradimin, shkatërrimin apo shterrimin e resurseve ujore, si dhe dëmtimin e mjedisit, natyrës, me rastin e përpilimit të raportit të VNM-së;¹⁷

14. Pika 2. e dispozitivit të Vendimit Nr. KNMU/V/02/2017, datë 10.01.2018,

15. Vendimi është nënshkruar nga Kryeministri i atëhershëm i Kosovës z. Ramush Haradinaj;

16. Vështrimi i Sigurisë së Ujërave të Kosovës, Banka Botërore, Qershor 2018;

17. Shih: <https://kallxo.com/lajm/shterpce-banoret-protестоjne-serish-ne-mbrojtje-te-lumit/>

- Moskthimin në gjendje të mëparshme të mjedisit pas përfundimit të punëve të HC¹⁸.
- Ndërtimi i HC pa lejet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi;
- Mosrespektimi i legjislacionit në fuqi më rastin e ndërtimit të HC, e posaçërisht të parqeve kombëtare dhe zonave të veçanta të mbrojtura, etj.

⇒ *Banorët duke protestuar në ndërtimin e HC në ZK Shtërpçë, nëntor 2019, © WWF*



⇒ *Pamjet nga ndërtimi i katër HC përgjatë lumit Lepenc, nëntor 2019, © WWF*

HC SHARRI



HC SHTËRPÇE



18. Shih: <https://kallxo.com/lajm/gropa-ne-vend-te-rezervuarit-te-ujit-decanasit-demoncojne-kompanine-qe-ndertoi-hidrocentralet/>

HC BREZOVICA



HC VICA



HC LEPENCI 3



Këto ankesa dhe shqetësime janë ngritur edhe në takimin e banorëve të fshatit Biti e Poshtme me përfaqësues të OJQ-ve dhe mediave, për çështjen e ndërtimit të hidrocentraleve në Shtërpcë, si vijon:

“Sa i përket punës së ankesave, unë nuk e di se ku nuk kemi bërë ankesë ne. Ne kemi mbetur pa asnjë pikë uji për 3 muaj dhe më pas e kanë mbushur nga Lepenci. Na janë prishur të gjitha makinat, pajisjet nga uji i papastër. E kam çu shishen plot lloq ka dalë që është uji i pijshëm. Desha të di si keni vepru ju në këto raste sepse është e pakuptimtë. Ata po vijnë nga të gjitha anët dhe po du me ditë a ka ndonjë formë sepse për neve uji është jetë dhe e kemi vetëm një kërkesë që mos na merrni lumin sepse kjo është e drejta jonë”.

Agron Rushiti, banor i fshatit Biti e Poshtme - Shtërpcë¹⁹

19. Proponcim ekskluziv për Kallxo.com, në Biti e Poshtme, Komuna Shtërpce, datë 11 Korrik 2020;



Takimi me banorët e fshatit Biti e Poshtme, Komuna Shtërpce²⁰

“Në të gjitha format i kemi provuar dhe në fillim avokatët na dilnin kundër sepse avokatët paguheshin nga Operatori Ekonomik më shumë. Kemi shku në komunë, këta nuk na kanë pranuar... As nuk na kanë thirrë kur është bërë dëgjimi publik të cilin e kanë mbajtur në komuna të tjera. Edhe serbët që janë me neve sot, nëse zihen në kamera (duke protesuar) i distancojnë (përjashtojnë nga puna). Tjetër çka po du me cekë është se kemi pasur edhe dhunë ndaj nesh kur kemi dalë në protesta. Na kanë qitë sprejin në sy dhe këto i ka pa edhe Evropa. Asnjë polic si ka marrë parasysh këto gjëra edhe pse kanë thënë që do të hetohet rasti. Ne këtu jemi vetëm, ata banorë që s’kemi emigruar. Ne ju kemi thënë që nuk e kundërshtojmë (hidrocentralin), vetëm marrojeni në formë të hapur sepse me këtë ujë ne kemi ujitur tokat dhe ka pasur peshqi këtu, tash nuk ka. Jemi mirënjohës prej njerëzve që na kanë ndihmuar. ”

Hamdi Rushiti, banor i fshatit Biti e Poshtme- Shtërpce²¹

Ky diskutim është bërë në takim me aktivistët nga Shqipëria që i ndanë përvojat e ngjajshme të banorëve në Shqipëri: mënyra se si i janë qasur ata këtij problemi është, citim:

“Njerëzit po humbin atë më të shtrenjtën e tyre, ujin. Në këto situata banorët ose informohen vonë ose nuk informohen fare. Ne në Shqipëri i kemi lumin Vjosa dhe e kemi lumin e fundit të egër të Evropë.”

Banorët kanë marrë aksionet e tyre ligjore të përbashkëta, me peticione, protesta dhe edhe me padi. Ne ia kemi dalë deri diku dhe jemi në procese gjyqësore ende, që janë brenda zonave të mbrojtura. Hidrocentralet dëmtojnë në mënyrë të tmerrshme. Hidrocentralet e vogla janë kryesisht në shtetet e zhvilluara.

20. Takim me banorët e fshatit Biti e Poshtme, e organizuar nga OJQ Eco-Albania, e përcjelluar live në media nga Kallxo.com, datë 11 Korrik 2020;
21. Proponim ekskluziv për Kallxo.com, në Biti e Poshtme, Komuna Shtërpce, datë 11 Korrik 2020;

Hidrocentralet e vogla nuk janë më të konkurueshme dhe nuk janë për energji. Energjia diellore dhe ajo e erës janë më të leverdishme, ndërsa këto janë të lidhura me politikën sepse gjërat bëhen të pranueshme për ta. Duhet gjithmonë të keni aleat siç janë mediat. Beteja tjetër është beteja ligjore dhe për këtë ju duhet avokatët të cilët janë gjithmonë çështje besimi. Të jeni të bindur që kompania që po ndërton ka bërë një vlerësim në mjedis, por (ky vlerësim) nuk ka të bëjë me realitetin. Ju duhet t'a mbron shtëpinë tuaj, komshinjtë mund t'ju ndihmojnë por në fund të fundit jeni ju ata që do të ruani shtëpinë tuaj.”

Olsi Nika, OJQ EcoAlbania²²

Poashtu, protesta të mëdha janë bërë edhe kundër ndërtimit të HC pranë lumit të Lumbardhit nga OE KelKos Energy, në Pejë.



Protestat në Pejë më 25 Shkurt 2019 me moton “MOS MA PREK LUMBARDHIN”²³

Si rrjedhojë e ankesave të shumta nga banorët me rastin e lëshimit të akteve juridike (pëlqimeve dhe lejeve) për ndërtimin e HC, të shkëlqeve të shumta nga ana e OE dhe institucioneve publike në njërën anë, si dhe të kërkesave të shumëta nga OE për ndërtimin e HC në anën tjetër, nga data 5 qershor 2019, ZRRE nuk pranon “aplikimet të reja” për t’u trajtuar. ZRRE ka marrë Vendim²⁴ për pezullimin e pranimit të këtyre aplikacioneve për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pasi që është duke u ballafaquar me numër të madh të aplikuesve për marrjen e autorizimit preliminar dhe përfshirje në Skemën Mbështetëse si “aplikacionë në pritje” jashtë caqeve të disponueshme të BRE.²⁵

Së fundi është themeluar Komisioni Ndër-ministror për Ujërat²⁶, i ri.

KOSID ka kërkuar nga **Këshilli Ndër-ministror për Ujërat** të komentojë lidhur me këto shkëlqe duke dërguar e-mail me 28 tetor 2020 por deri në datën e publikimit nuk ka pranuar ndonjë koment.

22. Prononcim i dhënë nga Olsi Nika, nga OJQ Eco Albania, në takimin me KOSID dhe banorët e fshatit Biti e Poshtme me datë 11 Korrik 2020;

23. Shih: <https://www.njeshi.com/index.php/2019/02/25/drejtperdrejt-protesta-ne-peje-mos-ma-prek-lumbardhin/>

24. Vendim, Kodi i ZRRE-së: Nr. V_1160_2019, datë 05 Qershor 2019, shih: http://ero-ks.org/2019/Vendimet/V_1160_2019.pdf

25. Caqet e disponueshme të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 05/ Nr. 05/2017 për Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme.

26. Vendimi i Qeverisë Nr. 07/31, datë 21.09.2020, shih: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/10/Vendimet-e-mbledhjes-së-31-të-të-Qeverisë.pdf>

II. SHKELJET LIGJORE ME RASTIN E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË

Me rastin e analizës së procesit të dhënies së pëlqimeve dhe lejeve (ujore, mjedisore, ndërtimit, etj.) të lëshuara nga insitucionet publike qeveritare dhe ato komunale, për ndërtimin e hidrocentraleve në Kosovë, rezulton se i gjithë ky proces ka filluar jashtëligjshëm, si dhe i njejtë ka përcjellur shkelje tjera ligjore.

Fillimisht, trajtimi i kërkesave të operatorëve ekonomikë nga institucionet publike qeveritare dhe komunale për lëshimin e lejeve ujore është bërë në kundërshtim me **Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës**.²⁷

Këto kërkesa janë trajtuar si kërkesa të thjeshta (kërkesa për leje ujore) dhe pa procedura të konkursit publik, ndërsa ky ligj përcakton që **veprimtaritë afariste për shfrytëzimin e fuqisë së ujit nga trupat ujorë sipërfaqësor dhe nëntokësorë, për prodhimin e energjisë elektrike realizohen vetëm përmes ndarjes së koncesionit**.²⁸

Poashtu, ndarja e këtyre koncesioneve duhet të bëhet sipas Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat²⁹, të cilat kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve publike dhe/ose infrastrukturës publike në të gjithë sektorët ekonomikë dhe shoqërorë, përfshirë prodhimin, distribuimin, trajtimin, mbledhjen dhe administrimin e ujit, ujërave të zeza, drenazhës, ujitjes dhe kanaleve.³⁰

Prandaj, kërkesat për leje ujore për hidrocentrale nuk mund të trajohen si kërkesa të thjeshta, meqë është në pyetje prona dhe resurset ujore të cilat janë publike. Pra, këto resurse nuk mund të vihen në dispozicion për OE për shfrytëzim të tyre për qëllime ekonomike përmes kërkesave të thjeshta për leje ujore. Por, kërkesat e tilla ligjorisht duhet të trajtohen dhe lëshohen vetëm përmes koncesioneve dhe procedurave të konkursit publik.

Dhënia koncesionit për OE për shfrytëzimin e resurseve ujore për prodhim të energjisë elektrike, duhet të bëhet përmes shpalljes publike në të cilën përcaktohen kriteret për dhënien e resurseve për shfrytëzim me koncesion, ku konkurojnë OE.

Koncesioni jepet për afat të caktuar, përcaktohen kushtet në të cilat OE duhet rikthyer gjendjen natyrore dhe të objekteve të ndërtuara të HC në vend, si dhe përcaktohet shuma dhe mënyra e kompensimit koncesional, të cilat mjete duhet të derdhen në buxhetin e Kosovës.³¹

Në këtë drejtim, sipas kompetencave, ndarja e koncesioneve bëhet nga **Ministria për Ekonomi dhe Ambient**³². Ndarja e koncesionit duhet të bëhet përmes konkursit publik, të organizuar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, si dhe Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat.³³

Përveç kësaj, koncesioni nuk mund të jepet kur me të rrezikohet furnizimi me ujë të pijshëm, bilanci i prodhimit të ushqimit dhe bilancet tjera ekonomike.³⁴ Gjithashtu, është mirë e ditur se resurset ujore

27. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

28. Neni 78 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;

29. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>

30. Neni 2, para 1.4 i Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat

31. Neni 78, para. 6 i ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;

32. Ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe ish Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) të cilat janë bashkuar, sipas Neni 2, Shtojca 9 e Rregullores (QRK) - nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29389>

33. Neni 79 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;

34. Neni 78, para. 4 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;

janë resurse publike të mbrojtura me kushtetutë³⁵ dhe legjislacionin përkatës. Përkundër gjithë këtyre të drejtave të precizuara në legjislacion, që të gjitha janë anashkaluar dhe shpërfillur në tërësi deri më tani.

Se është një gjendje alarmante lidhur me trajtimin jo të duhur të resurseve ujore në Kosovë, ku e rëndon situatën shumë ndërtimi i HC-ve, konfirmon edhe vlerësimi i ekspertit të ujërave, Avdi Gjonbalaj

“Nuk ka të drejtë askush të lirojë operatorët ekonomikë nga kompensimi koncesional me rastin e shfrytëzimit të resurseve ujore për qëllime të përfitimeve ekonomike të prodhimit të energjisë elektrike. Prandaj, që të gjitha lejet (ujore, mjedisore, ndërtimit, etj.) për OE të HC janë dhënë në kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës.

Përveç kësaj, të gjitha këto leje të lëshuara deri më tani për HC janë dhënë pa u bërë analiza të mirëfillta hidrologjike, mjedisore, pa i analizuar dhe marrë për bazë asnjë nga analizat e mëparshme dhe parametrat që posedojnë institucionet nga e kaluara.

Fatkeqësisht, kështu ka ndodhur me rastin e lëshimit të këtyre lejeve në Lepenc, në zonën e akumulimit në Firajë, si dhe është përjashtuar mundësia e akumulimit të ujit në Slopkë, Bistrica e Deçanit. Prandaj, e kanë dënuar Deçanin mos me pas ujë për me i plotësu nevojat elementare dhe ato për ujitje për banorët e Deçanit.

Poashtu, nuk janë freskuar matjet në nivel vendi për resurset ujore, ndërsa rrethanat kanë ndryshuar, pasi që topografia ka mbetur e njëjta, por prurjet ujore kanë luhajte, si dhe ka ndryshuar kapaciteti i përdorimit dhe shfrytëzimit të ujit.

Me rastin e lëshimit të lejeve për OE, institucionet publike qeveritare askund nuk e kanë detyruar OE që para marrjes së ujit dhe pas lëshimit të ujit të bëjnë matjen automatike të kapacitetit të ujit. Pra, shteti duhet ditur se kur OE i plotëson kushtet për përdorimin e ujit dhe si i plotëson ato.

Nuk është punuar në atë drejtim të hidrologjisë, që të përcaktohet kuartë se sa muaj do të punojë hidrocentrali, ku hiqet minimumi dhe maksimumi i kapacitetit të ujit të cilën nuk mund t'a vësh në gypa, si dhe të llogaritet shuma reale e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike. E në bazë të kësaj të paguhet shuma e kompensimit koncesional ndaj shtetit.

Të gjitha këto anashkalime përbëjnë krime ekonomike të rënda ngase askush nuk posedon autorizime të tilla që të dorëzojë pronat publike në dispozicion të OE për qëllime të përfitimeve ekonomike, dhe aq më tepër duke mos u kompensuar shteti.

Gjithashtu, duhet pasur parasysh që të zhvillojmë politika publike në baza të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë, ku duhet të mendojmë për gjeneratat e ardhshme, ngase Kosova nuk posedon mënyra tjera për sigurim të ujit, përveç se përmes akumulimeve ujore.

Rrjedhimisht, ne si shtet nuk po i mbledhim të ardhurat e duhura dhe të plota nga operimi i HC ashtu si meritojmë, ndërsa OE nuk janë obliguar me akt koncesional, ku me rastin e përfundimit të kontratës së tyre të operimit, objektet e HC duhet t'i trashëgojë dhe mbeten në menaxhim të institucioneve publike të shtetit. Në përmbledhje, të gjitha këto janë në kundërshtim me të gjitha normat e rregullimit shtetëror “.³⁶

Avdi Gjonbalaj, Inxhinier Hidrologjik

35. Shih Neni 122 - Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore, para. 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, citim “Në Republikën e Kosovës pasuritë natyrore si ujërat, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, e pjesët e tjera të natyrës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi”.

36. Intervistë e KOSID me Avdi Gjonbalaj, inxhinier hidrologjik, me përvojë të gjatë pune në Ministrinë e Mjedisit, si dhe në institucione të tjera publike mbi menaxhimin e ujërave në Kosovë, 2 Tetor 2020;

Në funksion të adresimit të këtyre parregullësive dhe shkeljeve ligjore, komuniteti në mbështetje të OJQ-ve, përfshirë edhe vetë KOSID, kanë reaguar në forma të ndryshme për degradimin e lumenjve që po bëhet në disa vende të Kosovës duke i shkaktuar dëme resurseve ujore, popullatës dhe natyrës.

Si rrjedhojë, për adresimin e këtyre parregullësive serioze që janë bërë në Kosovë, Kuvendi i Kosovës me 14.08.2020 ka formuar **Komisionin Hetimor Parlamentar për Procesin e Licencimit, Operimit, Mbikëqyrjes dhe Operimit për Leje të Hidrocentraleve**³⁷, i cili pritet të bëjë identifikimin dhe adresimin e këtyre dukurive të HC në nivel vendi. Poashtu, edhe vetë Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, është angazhuar dhe zotuar në adresimin e kësaj çështje:

“Angazhimi për vlerësim të drejtpërdrejt të zhvillimeve rreth projekteve të hidrocentraleve të vogla në Kosovë nuk është vetëm obligim profesional duke qenë në krye të institucionit më të lartë ligjvënës në vend, por është mbi të gjitha obligim moral si qytetare e këtij vendi dhe si e deleguar e qytetarëve për të mbrojtur interesat e tyre, sepse dëmi që po i shkaktohet mjedisit po bëhet çdo ditë e më shumë i parikuperueshëm. Një gjë është e qartë, derisa do vazhdojmë me mendësinë që zhvillimi ekonomik të arrihet duke vepruar në dëm të mjedisit, nuk do të kemi mundësi të garantojmë mirëqenie të plotë për qytetarët tanë, sepse shëndeti ynë është ngusht i ndërlidhur me shëndetin e natyrës.”

Zhvillimi ekonomik është pamëdyshje qëllimi i përbashkët i të gjithëve, por çdo investim që bëhet në vendin tonë me potencial për të kontribuar në këtë drejtim duhet të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi. (Ky investim) duhet të realizohet duke mundësuar përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve tanë, si dhe duhet të bëjë jetën tonë - të të gjithëve pa dallim dhe jo vetëm një grupi të caktuar - më të mirë dhe jo e kundërta.

Burimet e ripërtëritshme të energjisë janë e ardhmja, por investimet në këtë drejtim, në veçanti në hidroenergji, kanë kuptim veç kur ato burime mbesin vërtetë të tilla - të ripërtëritshme dhe nuk eksploatohen e degradohen nga grupe të papërgjegjshme të shoqërisë tonë. Duke e kuptuar se sa serioze është situata, në Kuvendin e Kosovës kemi themeluar komisionin hetimor mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në Republikën e Kosovës. Ne nuk kemi lumenj për të falur, andaj nuk do të kursehem në angazhimin tim për mbrojtjen e tyre!”³⁸

Vjosa Osmani, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve në Parkun Kombëtar “SHARRI” e kundërshtojnë edhe vetë zyrtarët e institucioneve përkatëse publike:

“Drejtorja për Administrimin e Parkut Kombëtar është kundër çdo degradimi të natyrës dhe çdo prishje të habitateve dhe ekosistemeve të Parkut Kombëtar “SHARRI” për përfitime personale pasi që Parku Kombëtar “Sharri” është zonë e mbrojtur me ligj.”³⁹

Bujar Kafexholli, Drejtor i Drejtoratit për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”

37. Shih: <http://www.kuvendikosoves.org/shq/komisionet/>

38. Intervistë e KOSID me Vjosa Osmanin, kryeparlamentare, 01 Tetor 2020;

39. Intervistë e KOSID me Bujar Kafexholli, Drejtor i Drejtoratit për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, 06 tetor 2020;

Të njëjtin vlerësim e japin edhe nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës:

“Ne mendojmë që ndërtimi i hidrocentraleve në Parkun Kumbëtar “Sharri” është i papranueshëm dhe është degradues i drejtpërdrejtë i biodiversitetit ku ndikon në shkatërrimin e florës dhe faunës në Parkun Kombëtar “Sharri”.”⁴⁰

Fadil Bajraktari, Drejtor i Institutit për Mbrojtjen e Natyrës

Poashtu, edhe në komunikimet zyrtare në mes të institucioneve publike, me rastin e shqyrtimit të kërkesave për ndërtimin e HC nga OE në parqe kombëtare, përfaqësues zyrtar dhe kompetentë përbrenda Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës kanë reaguar me shkrim ndaj Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht ndaj ish-Ministrit Fatmir Matoshi dhe ish-Sekretarit të MMPH (tani MEA) duke kërkuar ndalimin e lëshimit të lejeve mjedisore për ndërtimin e HC në parqet kombëtare.⁴¹

Por, përkundër kësaj, ish-Ministri Matoshi dhe ish-Sekretari i Përgjithshëm i MMPH z. Arben Çitaku kanë lejuar vazhdimin e punimeve pasi që këto HC janë në ndërtim e sipër duke shpërfillur vlerësimin e stafit profesional dhe kompetent. Një përmbledhje e tillë është bërë specifikisht poashtu për kërkesat e OE të bëra për ndërtimin e HC në Parkun Kombëtar “Sharri”, për çka prapë ish-Ministri dhe ish-Sekretari i MMPH, kanë shpërfillur kërkesat e stafit profesional vlerësues brenda MMPH-së të cilët kanë kërkuar që të mos bëhet lëshimi i lejeve mjedisore në Parkun Kumbëtar “Sharri”. Kjo për shkak se përveç që është zonë e veçantë e mbrojtur me ligj, poashtu ndërtimi i HC ka pasoja të mëdha negative ligjore, ekologjike dhe socio-ekonomike të minishidrocentraleve për Parkun Kombëtar Sharri.⁴²

KOSID ka kërkuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Z. Blerim Kuçi të komentojë lidhur me këto shkelje duke dërguar e-mail me 29 tetor 2020 por deri në datën e publikimit nuk ka pranuar ndonjë koment.

Ndërsa, një reflektim më i detajur ligjor, mbi raste aktuale të studimit të hidrocentraleve, HC në Kosovë është si vijon:

⇒ Ndërtimi i katër HC, siç janë **HC Sharri (6.453 MW)**, **HC Vica (4.6 MW)**, **HC Brezovica (2.01MW)** dhe **HC Shtërpce (5.031MW)**, që të katër këto HC janë duke u ndërtuar në faza të ndryshme nga i njëjti OE, e që të gjithë HC burimin ujqor e kanë të përbashkët nga Lumi Lepenc.⁴³ Ndërsa, **HC Lepenci 3 (9.998MW)**, së fundi në korrik 2020 është licencuar për prodhim të energjisë elektrike, ku prapë OE “Matkos Group” Sh.P.K. i njëjti është në investim të përbashkët me investitorë të tjerë.⁴⁴


40. Intervistë e KOSID me Fadil Bajraktari, Drejtor i Institutit për Mbrojtjen e Natyrës, 07 Tetor 2020;

41. Raporti dhe njëherit kërkesa e Fadil Bajraktari, Drejtor i IKMN, Fatmir Morina, Drejtor i Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe Bujar Kafexhollli, Drejtor i Parkut Kombëtar “Sharri”, që të tre i kanë dërguar Ministrin Fatmir Matoshi dhe Sekretarin të Ministrisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Arben Çitaku, me datë 04.03.2019, AMMK, me nr. prot. 1146/19, prej 6 faqe, me titullin “Hidrocentralet në Parqet Kombëtare, rrezik për biodiversitetin.

42. Raport mbi pasojat negative ligjore, ekologjike dhe socio-ekonomike të minishidrocentraleve për Parkun Kombëtar Sharri, përpiluar nga Bajram Kafexhollli, Drejtor për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri”, drejtuar ish-Ministrit Fatmir Matoshi dhe ish-Sekretarit Arben Çitaku, AMMK, datë: 557/19, datë 04.02.2019;

43. Vendimet për autorizimet finale të lëshuara nga ZRRE, për HC Shtërpce Vendimi Nr. V_1226_2020 i dt. 12.02.2020, shih: http://ero-ks.org/2020/Vendimet/V_1226_2020.pdf; për HC Sharri - Vendimi Vr. V_1225_2020, i datës 12.02.2020, shih: http://ero-ks.org/2020/Vendimet/V_1225_2020.pdf, si dhe për HC Vica-Vendimi NR. 1202_2019 i dt. 27.11.2019, shih: http://ero-ks.org/2019/Vendimet/V_1202_2019.pdf

44. Shih HC Hidroenergji, Vendimi Nr. ZRRE/Li_63_20, datë 03.07.2020;



Hydrocentralet në ndërtim pranë Lumit Lepenc © World Wide Fund, November 2019⁴⁵

Lidhur me ndërtimin e këtyre HC pranë lumit Lepenc, banorët e vendit kanë protestuar⁴⁶ vazhdimisht dhe janë ankuar⁴⁷ lidhur me ndërtimin e këtyre HC, të cilat po shkakojnë dëme të shumfishta. Këto dëme po bëhen mbi ekosistemin e vendit po shkaktojnë përmytjet nga ujërat si rezultat i çrregullimit të rrjedhave ujore nga punimet e HC⁴⁸, po bëjnë degradimin e tokës si dhe ndërprerjen e rrjedhave ujore përgjatë tokave të tyre bujqësore dhe ato të banimit.

Ndër mospërfilljet ligjore të legjislacionit kombëtar në fuqi më të theksuara nga punimet e OE me rastin e ndërtimit të **HC përgjatë lumit Lepenc**, janë:

► **Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor të “MATKOS GROUP” Sh.P.K.**⁴⁹ - Bazuar në vlerësimin e të gjeturave në raportin për VNM mbi këto HC, janë një mori shkeljesh ligjore si vijojnë:

1. Raporti nuk përfshin fare në përmbajtjen e saj ndërhyrjen e ndërtimit të HC në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “SHARRI”, vendosjen e digave për furnizimin/marrjen e ujit për këto HC (Shih hartën e hidrocentraleve të WWF, Nëntor 2019), ku bëhet edhe shkelja e rëndë e Ligjit Nr.04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri”.⁵⁰

2. Në tërësinë e tij, raporti i VNM-së është përshkruar tekstual, ndërsa nuk ofron fare vlerësime mbi gjendjen aktuale me njësi matëse dhe parametra konkretë mbi gjendjen e botës bimore, shtazore, ekosistemit si tërësi, duke mos u thirrur fare në vlera apo parametra matës mbi ndikimet mjedisore.

45. Të dhënat janë marrë nga VNM 2014 e Matkos Group, e cila bazohet në sistemi e vjetër të hartave gjeografike, si dhe në bazë të vëzhgimeve në vend dhe punimeve deri në Nëntor 2019, të cilat nuk mund të jenë shumë precize, por të përafërta.

46. Shih: <https://kallxo.com/lajm/banoret-e-bitise-se-poshtme-ne-protesta-edhe-ne-kohen-e-coronavirusit/>

47. Shih: <https://kallxo.com/lajm/shterpce-banoret-protestojne-serish-ne-mbrojtje-te-lumit/>

48. Shih: <https://kallxo.com/lajm/permytjen-arat-e-banoreve-te-bitise-se-poshtme-shkaku-i-ndertimit-te-hidrocentralit/>

49. Raporti i Vlerësimit të Ndimit në Mjedis për Matkos Group SH.P.K., përpiluar nga Eksperti i Autorizuar për VNM Z.Islam Fejza, Kompania: Geo-Mining, adresa: Prishtinë;

50. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2866>

3. Në pjesën “ndikimet gjatë fazës së funksionimit të hidrocentraleve”, fq. 77, raporti përshkruan se do të ketë “*ndikime në zvogëlimin e sasisë së ujit të lumit e cila ndikon negativisht në habitatin bimor dhe shtazor të cilat zhvillohen në lum.*” Kjo përbën kërcënim serioz natyror mbi sasinë e ujit për banorët e vendit, të cilët edhe kanë protestuar lidhur me këtë.

4. Raporti përcakton marrjen e 60-65% të prurjeve normale të ujit në çdo stinë, ndërsa mbetja ekologjike e ujit të jetë 35-40%. Këtu do të llogaritet (shiqohet) minimumi biologjik i ujit dhe varësisht prej saisë së prurjeve do të shfrytëzohet sasia e ujit, e në rast se sasia e prurjeve është e vogël, puna e hidrocentraleve do të ndërpritet.⁵¹ Kjo tregon për sasinë e madhe të konsumit të ujit nga HC, e që natyrshëm vërehet disbalanci i prezencës ujore për ekosistemin si tërësi, e cila domosdoshmërisht ndikon në çrregullimin mjedisor, të natyrës, zvogëlimin e fuqisë së ujit për përdorim për ujitje për banorët e vendit.

5. Ky raport nuk ka paraparë asnjë ndikim të kombinuar në mjedis me projektet tjera ekzistuese dhe/ose ato që do të ndërtohen në të ardhmen.⁵²

6. Raporti nuk përfshin fare vlerësime të ndjeshmërisë mjedisore të zonave gjeografike që mund të ndikohen nga projekti mbi sasinë, cilësinë dhe kapacitetin regjenerues të burimeve natyrore në zonë, si dhe ndikimet mbi popullatën.⁵³

7. Raporti nuk përmban një përshkrim të detajuar të ndikimeve të mundshme e të theksuara të projektit të propozuar në mjedis, si: ndikimet e drejtpërdrejta dhe çfarëdo ndikimi i tërthortë, sekondar, kumulativ, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, i përhershëm dhe i përkohshëm.⁵⁴

- **HC Sharri (6.45MW)** - ka ndërtuar (rezervuaret dhe tubacionet), shih (Furnizimi 1, 2 dhe 3) përbrenda **Zonës së Mbrojtur sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës**, si dhe **Ligjit Nr. 04/I-087 për Parkun Kombëtar “Sharri”**. Për më tepër, “*Parku kombëtar është zonë e gjerë e tokës dhe/ose ujit, me vlera të jashtëzakonshme dhe të shumëllojshme natyrore, përfshin një ose më shumë ekosisteme natyrore të ruajtura ose pak të ndryshuara dhe kryesisht dedikohet për ruajtjen e vlerave burimore të natyrës.*”⁵⁵ Me këto veprime, **është shkelur Neni 11, para. 4, i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës**, citim **“në parkun kombëtar ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës.”**
- **HC Shtërpcë (5.031 MW)** - i ka ndërtuar (rezervuaret dhe tubacionet), shih (Marrje 1 dhe potencialisht Marrje 2) përbrenda Parkut Kombëtar “SHARRI”, e cila është zonë e mbrojtur me ligj dhe shkeljet ligjore ndaj legjislacionit të mbrojtjes së natyrës dhe parkut kombëtar janë të njëjtat sikurse në rastin e HC “Sharri”.

Lidhur me këto hidrocentrale, edhe në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar “Sharri” është e precizuar se edhe po nëse do të bëhet ndonjë ndërtim potencial, i njëjti duhet të jetë objekt i **“koncesioneve territoriale brenda zonës do të jetë subjekt i marrëveshjeve ligjore që përcaktojnë kufijtë dhe kërkesat e ndërtimit, përdorimin, aktivitetet dhe kushtet mjedisore”**⁵⁶.

51. Pika 6.3. Masat e marrura për mbrojtjen e ujit, Raporti i VNM, fq. 83-84.

52. Kjo kërkohet sipas Shtojca 3 e Ligjit Nr. 3/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

53. Kjo kërkohet sipas Shtojca 3 e Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

54. Shih Neni 15 i Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

55. Shih Neni 11, para 1 i Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

56. Plani i Menaxhimit të Planit Kombëtar SHARRI, Strategjia 10-vjeçare e menaxhimit 2014-2023, 7.3 - Zona e Përdorimit të Qëndrueshëm, pika 5, shih: https://mmph.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Plani_i_menaxhimit_i_PK_Sharri_verzoi_shqipe_342423.pdf

- **HC Lepenci 3** (9.998 MW) i cili është pajisur me Licencën Nr. ZRRE/Li_63/20 për Prodhimin e energjisë elektrike nga BRE me datë 03.07.2020 për periudhë katërdhjetë (40) vjeçare⁵⁷, pa e siguruar Lejen Mjedisore me rastin e lëshimit, sipas Neni 14 - Mjedisit të Licencës, citim **“I licencuari do t’i dërgojë Rregullatorit kopje të Lejes Mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe dokumentet tjera të lëshuara nga ministria përkatëse për mjedis”**.

KOSID ka kërkuar nga MATKOS Group Sh.p.k të komentojë lidhur me këto shkelje duke dërguar e-mail më 27 tetor 2020 por deri në datën e publikimit nuk ka pranuar ndonjë koment.

Edhe në rastin e këtij operatori ekonomik, ZRRE ia ka mundësuar që të pajiset ndërkohë me Leje Mjedisore. Kjo nuk mund të tolerohet dhe kjo **përbën shkeljen e Nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, i cili përcakton se *“lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të fillojë veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.”*⁵⁸

Pra nga kjo që kuptohet, ZRRE në kohën e lëshimit të licencës së përhershme për 40 vjet, OE nuk e ka poseduar dhe dorëzuar Lejen Mjedisore në ZRRE me rastin e aplikimit për licencim, me ç’rast është shkelur edhe Neni 30, para 1, pika 3 dhe para. 2, pika 3 e Ligjit Nr. 05/L-84 për Rregullatorin e Energjisë, citim *“ndërmarrjet e energjisë elektrike që sigurojnë fakte që stabilimentet e energjisë që përdoren për aktivitete që i plotësojnë kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe mjedisit,” si dhe “kriteret për dhënien e licencës do të ndërliken, deri në masën përkatëse të kërkesave të licencës me mbrojtjen e mjedisit.”*

Në pëmbledhje, lidhur me këto kushte **nuk mund të bëhet shpërfillje ligjore nga ZRRE dhe të jepet licenca për OE që në ndërkohë OE kurdo që e siguron Lejen Mjedisore ta dërgojë në ZRRE.** Se është kështu, precizohet në Nenin 30, para. 3 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, citim **“licencat mund të përmbajnë kushte të cilat Rregullatori i konsideron si të nevojshme për aktivitetet që do të ndërmerren, si dhe ato mund të përfshijnë kushtet..”** por këtu janë të përfshira çështje të tjera dhe jo lejet mjedisore.

Me këtë veprim poashtu është shkelur Neni 9, i Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë Elektrike, 2017 citim *“aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dëshmitë, si në vijim: **leje mjedisore lëshuar nga institucioni kompetent** (aty ku është e aplikueshme); gjatë periudhës së aplikimit, pëlqimi mjedisor do të jetë i mjaftueshëm”.* Siç dihet, në praktikë Leja Mjedisore dhe Leja Ujore janë dokumente/instrumente ligjore të cilat poashtu janë mbrotjëse të resurseve natyrore dhe të të drejtave të komunitetit.

Kur OJQ-të kishin reaguar ndaj ZRRE-së lidhur me HC në Grykën e Deçanit, duke pyetur se si është e mundur që lëshohet leja e operimit para se të merret leja mjedisore dhe ujore për HC në Deçan, ZRRE në fund, në mbledhjen që mbajti më 14 tetor 2020 nuk e vazhdoi lejen së operimit duke ia tërhequr licencën për operim KELKOS-it, kompanisë që menaxhon me HC në Grykën e Deçanit. Kjo ndodhi pas aktivizimit të OJQ-ve vendore dhe mbikqyrjes mediale të këtij problemi, por gjithashtu ndodhi pas shumë viteve degradimi që i ishte bërë Bjeshkës së Deçanit gjë të cilën aktivistët e quajtën shfrytëzim

57. Vendimi Nr. V_1184_2019, datë 03 Korrik 2020, i lëshuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, i nënshkruar nga Z.Arsim Janova, U.D.

Kryesues i Bordit, shih: https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/V_1267_2020_0.pdf, si dhe licenca shih: https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Vendimet/Licence%20per%20Prodhim%20te%20Energjise%20Elektrike%20-%20Hidroenergjij%20Sh_P_K_2.pdf

58. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

përtej normave të lejuara të resurseve ujore, që degraduan edhe ekosistemin në tërësi në atë rajon.⁵⁹ Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga inspektimet e inspektoratit komunal.⁶⁰

KOSID ka kërkuar nga ZRRE të komentojë lidhur me këto shkelje duke dërguar e-mail më 29 tetor 2020 por deri në datën e publikimit nuk ka pranuar ndonjë koment.



Gjendja mbi lumin Bistrica pas fillimit të ndërtimit të HC 2018 ♥ Atdhe Mulla


“ Unë e quaj tragjedia më e madhe e krimeve mbi natyrën në Kosovë”.

Shpresa Loshaj, OJQ “Pishtarët” në Deçan⁶¹

59. Shih: <https://prishtinainsight.com/the-fight-for-kosovos-vanishing-rivers-mag/>

60. Shih: <https://kallxo.com/gjate/hulumtim/vjetersohet-lenda-ndaj-kompanise-qe-planifikon-te-investoje-miliona-ne-hidrocentrale/>

61. Shih: <https://kallxo.com/lajm/gropa-ne-vend-te-rezervuarit-te-ujit-decanasit-denoncojne-kompanine-qe-nderto-hidrocentralet/>



Harta 1. Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna – Zonimi (Burimi: MMPH, 2018). Harta 2. Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna – Hidrocentralet ekzistuese (zezë) dhe ato në planifikim (kuqe)/ndërtim (verdhë), (Burimi: Riverwatch, 2018).

⇒ Mospërfilljet ligjore më të theksuara nga punimet e OE me rastin e ndërtimit të 3 HC në grykën e Deçanit nga i njëjti OE janë:

► **Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor të “KelKos Energy” Sh.P.K.**⁶² - Bazuar në vlerësimin e gjetjeve në raportin për VNM mbi HC-të e ndërtuara përgjatë Lumit Deçan, janë një mori shkeljesh ligjore. Banorët ankohen se një raport i tillë nuk prezenton kushtet dhe rrethanat reale mbi gjendjen dhe resurset ujore e mjedisore, por të njëjtat përshkrime i janë përshtatur kërkesave dhe interesave të OE. Analiza e KOSID ka identifikuar vërejtjet në këtë VNM si vijojnë:

1. Raporti i VNM-së së “Kelkos Energy” SHPK nuk përfshin fare në përmbajtjen e saj ndërhyrjen e ndërtimit të HC në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” vendosjen e digave për furnizimin/marrjen e ujit për këto HC (Shih hartën Riverwatch, 2018), ku bëhet edhe shkelja e rëndë e Ligjit Nr.04/L-086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”;⁶³

2. Ndërtimi i HC në Zonën e Veçantë të Mbrojtur të Manastirit të Deçanit është **në kundërshtim me Nenin 5 të Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura**, citim “ Çdo aktivitet i ri do të ndalohet për shfrytëzimin e burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike, etj.”⁶⁴

62. Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për KelKos Energy SH.P.K., përpiluar nga Eksperti i Autorizuar për VNM Z.George Berger, Kompania: Chartered Engineering Consultant Tschernutter, adresa: 9500 Villach, në Austri, Mars 2011, si dhe Kontraktori Inxhinierik për Raportin e VNM-së: Kelag -Kärntner Elektrizitäts-AG, adresa: Arnulfplatz 2, 9020 Klagenfurt, Austri;

63. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2865>

64. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529>

3. Lidhja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Manastirit të Deçanit⁶⁵ dhe OE KelKos Energy është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, pasi që i njëjti nuk e parasheh një mundësi të tillë.

4. Në asnjë vend nuk pasqyrohet përfshirja/mospërfshirja e banorëve të vendit me rastin e përpilimit të këtij raporti. Në këtë drejtim, është e qartë se Manastiri i Deçanit nuk përfaqëson të gjithë banorët e rrethinës, të cilët afektohen nga punimet e HC në rajon.

5. Raporti i VNM-së në asnjë vend nuk e konsideron përfshirjen e Komunës së Deçanit, e cila posedon kompetenca territoriale në atë rajon.

6. Ky raport nuk ka paraparë asnjë ndikim të kombinuar në mjedis me projektet tjera ekzistuese dhe ose ato që do të ndërtohen ardhshme.⁶⁶

7. Përshkrimi i gjendjes jo të mirë të rrugëve apo gjendjes natyrore në disa pjesë të rrethinës ku bëhet ndërtimi i HC sipas raportit të VNM-së, nuk duhet të favorizojë një OE që t'i mundësohet ndërtimi i HC, i cili do të rregullojë rrugët për nevojat e HC, e në të njëjtën kohë të përfitojë komuna me rregullimin dhe shtrimin e rrugëve nga OE. Kjo është përgjegjësi e shërbimeve komunale dhe nuk duhet të vihet në favorizim duke i vlerësuar lartë OE dhe ndërtimin e HC, ngase i njëjti OE mund të shtrojë rrugë por shkakton dëme tjera të pa renovueshme në mjedis. E raporti është i shkruar në atë frymë që vetëm e favorizon OE për ndërtimin e HC, e jo përshkrimin e gjendjes reale.

8. VNM-ja e HC-të Kelkosit ka paraparë ndërtimin e një rezervuari të ujit, i cili do të vazhdojë të ekzistojë si një liqe artificial, por një gjë e tillë nuk është ndërtuar fare.⁶⁷

9. Ky raport nuk përfshin fare vlerësime të ndjeshmërisë mjedisore të zonave gjeografike që mund të ndikohen nga projekti mbi sasinë, cilësinë dhe kapacitetin regjenerues të burimeve natyrore në zonë, ndikimet mbi popullatën, e posaçërisht çështja nuk trajtohet fare fakti se sa e si do të ndikojë ndërtimi i HC-ve në gjallesat ujore dhe në peshkim.⁶⁸

10. Raporti i VNM-së nuk përmban një përshkrim të ndikimeve të mundshme të theksuara të projektit të propozuar në mjedis si: ndikimet e drejtpërdrejta dhe çfarëdo ndikimi i tërthortë, sekondar, kumulativ, afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, i përhershëm dhe i përkohshëm.⁶⁹

11. Raporti në pikën 1.3.5. ka paraparë që procedura e licencimit të bëhet përmes Koncesionit, ndërsa praktikisht, procedura është realizuar me trajtim të thjeshtë me licencë nga ZRRE, duke mos iu nënshtruar konkursit publik.

- **HC Deçani** (9.8 MW) - është njëri ndër HC të ndërtuar përbrenda **Zonës së Mbrojtur sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës**, si dhe **Ligjit Nr. 04/L- 086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”**. Për më tepër, *“Parku kombëtar është zonë e gjerë e tokës dhe/ose ujit, me vlera të jashtëzakonshme dhe të shumëllojshme natyrore, përfshin një ose më shumë ekosisteme natyrore të ruajtura ose pak të ndryshuara dhe kryesisht dedikohet për ruajtjen*

65. Të përfaqësuar nga z. Bishop Teodosije, e lidhur më datë 9 Qershor 2010 dhe KelKos Energy Sh.P.K., të përfaqësuar nga Drejtori z. Georg Woeber;

66. Kjo kërkohet sipas Shtojca 3 e Ligjit Nr. 3/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

67. Raporti i VNM-së e ka të përshkruar ndërtimit e liqenit artificial, por i njëjti nuk është ndërtuar fare. Kjo është konfirmuar edhe nga vetë banorët e vendit, të prononcuar për media, Shih: <https://kallxo.com/lajm/gropa-ne-vend-te-rezervuarit-te-ujit-decanasit-dendoncojne-kompanine-qe-ndertoi-hi-drocentralet/>

68. Kjo kërkohet sipas Shtojca 3 e Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

69. Shih Neni 15 i Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

e vlerave burimore të natyrës.”⁷⁰ Me këto veprime, është shkelur Neni 11, para. 4, i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, citim **”në parkun kombëtar ndalohej shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës.”**

Çështje tjetër ligjore është pajisja e OE me datë 14.10.2019 me **Licencën të Përkohshme Nr. ZRRE/Li_49/16 për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE** për periudhë 12 muaj⁷¹, ashtu që OE pa e siguruar Lejen Mjedisore me rastin e lëshimit të licencës, duke i’a mundësuar që të pajiset ndërkohë OE me Leje Mjedisore sipas Para. 8 i Arsytimit të Vendimit, citim **“me kusht që ndërmarrja të sjellë në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar, brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të këtij vendimi”**. Pra, OE nuk e ka poseduar dhe dorëzuar Lejen Mjedisore në ZRRE me rastin e aplikimit për licencim të prodhimit të energjisë.

Në këtë rast, ZRRE ia ka mundësuar OE që të pajiset ndërkohë me Leje Mjedisore. Kjo nuk mund të tolerohet dhe përbënë shkeljen e **Nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, i cili përcakton se *“lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.”*⁷²

Kështu është shkelur edhe Neni 30, para. 1, pika 3 dhe para. 2, pika 3 e Ligjit Nr. 05/L-84 për **Rregullatorin e Energjisë**, citim *“ndërmarrjet e energjisë elektrike që sigurojnë fakte që stabilimentet e energjisë që përdoren për aktivitete që i plotësojnë kërkesat për mbrojtje të shëndetit, sigurisë dhe mjedisit,” si dhe “kriteret për dhënien e licencës do të ndërliidhen, deri në masën përkatëse të kërkesave të licencës me mbrojtjen e mjedisit.”*

Prandaj, lidhur me këto kushte **nuk mund të bëhet shpërfillje ligjore nga ZRRE dhe të ipet licenca për OE që “nëndërkohë” OE “kurdo” që e siguron Lejen Mjedisore ta dërgojë në ZRRE**. Se është kështu, precizohet në Neni 30, para. 3 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, citim **“licencat mund të përmbajnë kushte të cilat Rregullatori i konsideron si të nevojshme për aktivitetet që do të ndërmerren, si dhe ato mund të përfshijnë kushtet...”** këtu janë të përfshira çështje të tjera, por jo leja mjedisore.

Me këtë veprim poashtu është shkelur Neni 9, i Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë Elektrike, 2017 *“aplikuesi që aplikon për marrjen e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, duhet të dorëzojë në ZRRE edhe dëshmitë, si në vijim: **leje mjedisore lëshuar nga institucioni kompetent** (aty ku është e aplikueshme); gjatë periudhës së aplikimit, pëlqimi mjedisor do të jetë i mjaftueshëm;”*

- **HC “Lumbardhi II”** (6.2 MW) përveç shkeljeve të njëjta të përshkruara në te HC “Deçani”, situatën në këtë rast e rëndon që ky HC ishte i shkyçur⁷³, pasi që OE i saj nuk kishte marrëveshje me KOSTT.⁷⁴ Përkundër kësaj, jashtëligjshëm, ky HC është licencuar nga ZRRE me **Licencë të Përkohshme Nr. ZRRE/Li_64/18 për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE**, për periudhë 12 mujore⁷⁵.

Në procedurën e rregullt do të duhej që fillimisht HC „Lumbardhi II“ të sigurojë lejen e kyçjes në KOSTT, të cilën do të duhet bashkangjitur në dokumentet e aplikimit, e më pastaj të shqyrtohej lënda për miratim nga ZRRE.

70. Shih Neni 11, para 1 i Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

71. Vendimi Nr. V_1184_2019, datë 14 Tetor 2019, i lëshuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, i përbërë nga: 1. Arsim Janova, U.D. Kryesues, 2. Besim Sejfiqaj, Anëtar, 3. Selman Hoti, Anëtar, 4. Izet Rushiti, Anëtar, shih: https://ero-kos.org/2019/Vendimet/V_1184_2019.pdf

72. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

73. Shih: <https://kallxo.com/lajm/zrre-licencon-operimin-e-tri-hidrocentraleve-ne-decan-njeri-licencohete-edhe-pse-eshte-i-shkycur/>

74. Shih: <https://kallxo.com/gjate/analize/zrre-vendos-ta-shkyce-nga-rrjeti-hidrocentralin-lumbardhi-ii/?fbclid=IèAR0T3c6BbèHaPelIKAP-MXP-NKiOG4pNvYygfqXBe2bXqOIQgUxggSoSVvAI>

75. Vendimi Nr. V_1182_2019, datë 14 Tetor 2019, i lëshuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, i përbërë nga: 1. Arsim Janova, U.D. Kryesues, 2. Besim Sejfiqaj, Anëtar, 3. Selman Hoti, Anëtar, 4. Izet Rushiti, Anëtar, shih: https://ero-kos.org/2019/Vendimet/V_1182_2019.pdf

Pra, ZRRE ia ka mundësuar OE që të pajiset ndërkohë me Leje Mjedisore. Kjo nuk mund të tolerohet dhe përbën shkeljen e **Nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, i cili përcakton se *“lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të fillojë veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.”*⁷⁶

Me këtë rast janë shkelur kriteret e përgjithshme për licencim të OE sipas **Neni 30 i Ligjit Nr. 05/L-84 për Rregullatorin e Energjisë**, si dhe kriteret specifike të aplikimit për licencë të gjenerimit **Neni 9 i Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë Elektrike, 2017**.

- **HC “Belaje”** (8.06MW) - shkeljet ligjore janë të njëjta sikurse ato të përshkruara në HC „Deçani“, me rastin e Licencimit të Përkohshëm të këtij **Licencën të Përkohshme Nr. ZRRE/Li_50/16 për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE**, për periudhë 12 muaj⁷⁷. Të gjitha këto parregullsi dhe shkelje ligjore pastaj shpiejnë në krijimin e një zinxhiri të shkeljes së disa ligjeve tjera të cilat prekin direkt të drejtat e qytetarëve/banorëve, mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit, zhurmës, pyjeve, ajrit, atë të mbeturinave, ndërtimit, etj.

KOSID e ka kontaktuar KELKOS-in për të marrë komentet e tyre rreth gjithë këtyre shkeljeve më 27 tetor 2020 dhe deri në datën e publikimit KELKOS nuk ka dërguar ndonjë koment.

76. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

77. Vendimi Nr. V_1183_2019, datë 14 Tetor 2019, i lëshuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, i përbërë nga: 1. Arsrim Janova, U.D. Kryesues, 2. Besim Sejfiqaj, Anëtar, 3. Selman Hoti, Anëtar, 4. Zet Rushiti, Anëtar, shih: https://ero-kos.org/2019/Vendimet/V_1183_2019.pdf

III. TË DREJTAT E KOMUNITETIT NË BASHKË-VENDIMARRJE PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË

Pjesëmarrja e komunitetit në bashkë-vendimmarrje për lejimin e ndërtimit të hidrocentraleve në Kosovë është e paraparë pothuajse në të gjitha fazat e pajisjes me dokumentet mbështetëse të aplikuesve për të lejuar ndërtimin e HC. Pjesëmarrja direkte dhe respektimi i opinionit dhe qëndrimit të komunitetit në regjionet, zonat e komunat që synohet të ndërtohen hidrocentralet është e paraparë si vijon:

1. **RAPORTI PËR VNM⁷⁸**- Konkludimet dhe rekomandimet kryesore, të përfshira në Raportin e VNM-së për Pëlqim Mjedisor, i nënshtrohen **debatit publik**.
2. **PËLQIMI PËR KUSHTET NDËRTIMORE⁷⁹** - Organi kompetent/Ministria parasheh kushtet ndërtimore për ndërtimin për ndërtimet e kategorisë III-të brenda tridhjetë (30) ditësh. Brenda shtatë (7) ditëve nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar për Kushte Ndërtimore, organi kompetent në koordinimin me aplikuesin vendos **njoftimin publik**.
3. **PËLQIMI MJEDISOR⁸⁰** - Rezultatet e konsultimeve të debatit publik dhe informatat e mbledhura mbi raportin e VNM-së duhet të merren parasysh gjatë marrjes së vendimit për Pëlqim Mjedisor.
4. **PËLQIMI UJOR⁸¹** - Publikut i sigurohet pjesëmarrja në procedurat e dhënies së pëlqimit ujqor për kushtet ujqore për objektet ose aktivitetet të cilat realizohen për qëllime komerciale përmes njoftimit publik.
5. **LEJE NDËRTIMORE⁸²** - **Organi kompetent/Ministria** parasheh kushtet ndërtimore për ndërtimin e kategorisë III brenda dyzet e pesë (45) ditësh dhe lëshon lejen ndërtimore. Organi kompetent (Ministria/ Komuna) pas vlerësimit të dokumentacionit të aplikuesit për lëshimin e lejes ndërtimore, **vendos se a do të ketë nevojë të thërrasë takimin e palëve të interesit**.
6. **LEJE UJORE⁸³** - Procedurat për përfshirjen e palëve të interesuara në vendimmarrje mbi lëshimin e lejes ujqore janë të njëjta sikurse procedurat për lëshimin e pëlqimit ujqor.
7. **LEJE MJEDISORE⁸⁴** - Nuk është e paraparë përfshirja e konsultimit publik me rastin e pajisjes së aplikuesit me Lejen Mjedisore. Megjithatë, përfshirja e **konsultimit publik** është e paraparë me rastin e lëshimit të pëlqimit mjedisor si dhe vlerësimit të raportit VNM-së, kur është i përfshirë konsultimi/debati publik.
8. **LICENCË PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE⁸⁵**- Licencat e lëshuara për prodhimin e energjisë elektrike të HC me fuqi mbi 5 MW, përfshirë licencat e përkohshme dhe të përhershme, i

78. Shih Neni 20 dhe 21 i Ligjit Nr. 03/l-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

79. Shih: Neni 3, para 1. pika 15, Neni 17, para 1. pika 1, Neni 18, si dhe Shtojca 1, para 1. pika 6 e Ligjit Nr. 04/L – 110 për Ndërtimin, si dhe Neni 12 i Udhëzimit Administrativ MMPH nr. 01/2019 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ddërtimore dhe Leje Rrënimin për Kategorinë e III-të të Ndërtimeve;

80. Shih: Neni 20 dhe 21 i Ligjit Nr. 03/l-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

81. Shih: Neni 4, para 1, pika 32, Neni 71, para 1, pika 2 i Ligjit Nr. 04/l-147 për Ujqërat e Kosovës, si dhe Neni 25 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore;

82. Neni 3, para 1. pika 17, Neni 17, para 1. pika 2., Neni 21 dhe Shtojca 1, para 1. pika 6 e Ligjit Nr. 04/L – 110 për Ndërtimin, si dhe Neni 14-18 i Udhëzimit Administrativ MMPH nr. 01/2019 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrënimin për Kategorinë e III-të të Ndërtimeve;

83. Shih: Neni 4, para. 1, pika 12, Neni 72, para 1. i Ligjit Nr. 04/l-147 për Ujqërat e Kosovës, si dhe Neni 25 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujqore;

84. Shih Neni 20 dhe 21 i Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

85. Neni 6 i Rregulla për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Neni 3, para.1. Shih: http://ero-ks.org/2017/Rregullat/2017.01.17_RREGULLA%20PER%20LICENCIMIN%20E%20AKTIVITETEVE%20TE%20ENERGJISE%20NE%20KOSOVE.pdf

nënshtrohen **konsultimit publik**. Me këtë rast, ZRRE obligon OE që ka aplikuar për t'u pajisur me licencë, të publikojë njoftimin për aplikim për pajisje me licencë në dy gazeta ditore me qarkullim të madhë në Kosovë. Nga data e publikimit, brenda 8 ditësh, palët e interesit kanë të drejtë të kundërshtojnë lëshimin e licencës dhe të adresojnë këto kundërshtime ZRRE-së. Këto kundërshtime ZRRE duhet t'i marrë parasysh dhe adresojë me rastin vendimarrjes për lëshimin e licencës apo refuzimin e saj.

Në përmbledhje, të gjitha konsultimet publike mbi vendimarrjen më rastin e lëshimit të dokumenteve të nevojshme për të pajisur OE, duhet të bëhen në respektim të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale⁸⁶, si dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna⁸⁷.

86. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

87. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>

IV. REALIZIMI I TË DREJTAVE LIGJORE TË KOMUNETIT NË MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË TYRE DHE MBROJTJEN E MJEDISIT

Korniza ligjore në fuqi e Republikës së Kosovës mundëson realizimin e të drejtave të komunitetit dhe të mjedisit përmes mjeteve juridike, pranë secilit institucion dhe në çdo fazë të ndërtimit të HC, si vijon:

⇒ **KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE** - Secili person gëzon të drejtën për qasje në dokumentet publike të lëshuara nga institucionet publike të Kosovës. Palët e interesuara për posedimin e dokumenteve publike të cilat prekin interesat e tyre të caktuara dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre mund të bëjnë përmes parashtrimit të Kërkesës për qasje në dokumente publike sipas Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike⁸⁸.

⇒ **LLOJI I ANKESËS / PADISË** - Palët e pakënaqura me vendimet/aktet juridike të lëshuara nga institucionet publike mund të parashtrorjnë ankesat/prendimet e tyre përmes ankesës/padisë individuale apo të përbashkët. Personi mund të jetë fizik apo juridik, apo që të dyjat bashkërisht. Kjo vlen për të gjitha fazat dhe pranë çdo institucioni.

⇒ **KUNDËRSHTIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE**
- Secila palë, të cilëve i'u është cënuar ndonjë e drejtë e tyre apo është cënëuar interesi shtetëror, mund të shfrytëzojnë mjetet juridike pranë institucioneve publike kundër akteve administrative (pëlqimi për kushtet ndërtimore, pëlqimi ujqor, pëlqimi mjedisor, raporti i VNM, leje ujore, leje mjedisore, leje ndërtimi, certifikatë përdorimi, licencë e përkohshme/përhershme për prodhimin e energjisë elektrike, etj.), si dhe përmes procedurës gjyqësore, si vijon:

I. KOMISIONI I ANKESAVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE - Përmes parashtrimit të **Ankesës pranë Komisionit të Ankesave** të institucionit që ka lëshuar aktin juridik ndaj të cilit inicohet ankimi. Sipas kornizës ligjore të institucioneve publike, secili institucion ka komisionin e ankesave të tij. Me rastin e pranimit të përgjigjes/vendimit të pakënaqur ndaj ankesës së palëve, palët ankimore përsëri kanë të drejtë të bëjnë **Ankesën e Dytë pranë Shkallës së Dytë të Komisionit të Ankesave** pranë institucionit që ka lëshuar dokumentin/vendimin e kundërshtuar, e cila është edhe mundësia e fundit e përdorimit të mjeteve juridike pranë institucioneve publike (këtu nuk përfshihet/konsiderohet shterimi i vazhdimit të mundësive për ankesë/padi në procedurat gjyqësore).

II. PROCEDURË GJYQËSORE - Palët e pakënaqura me vendimin e shkallës së dytë të Komisionit të Ankesave mbi vendosjen e ankesës së palëve, nga data e pranimit të Vendimit/përgjigjes finale nga institucioni publik që ka vendosur mbi ankesën parë/dytë, sipas Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative⁸⁹ palët mund të parashtrorjnë **Ankesë/Padi Administrative** kundër vendimit të ankimuar pranë **Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative**, e cila gjykatë është një dhe e vetme e cila vepron për tërë Kosovën.

Në rastet kur palët e ankimuar pranë institucioneve publike nuk pranojnë asnjë përgjigje nga institucioni lidhur me ankesën, atëherë palët mund të parashtrorjnë ankesë/padi ndaj heshtjes administrative të institucionit

88. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

89. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707>

në gjykatën.⁹⁰ Por, në rast se palët nuk i kanë shfrytëzuar mjetet juridike (ankesat në shkallën e parë dhe dytë) pranë institucioneve publike brenda afateve ligjore, nuk mund t'i drejtohen kësaj gjykate. Ndërsa, realizimi i kësaj procedurë bëhet sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.⁹¹

⇒ **KËRKESA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT TË SHKAKTUAR** - Sipas Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve⁹², palët të cilat kanë pësuar dëme, mund të parashtrajnë **Kërkesë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar/Padi Detyrimi**⁹³ pranë **Gjykatës Themelore për/në Komunën që është shkaktuar dëmi**⁹⁴ sipas legjislacionit në fuqi.⁹⁵ E tërë procedura gjyqësore për këtë çështje zhvillohet sipas Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore⁹⁶. Padia për kompensimin e dëmit mund të parashtrohet nga pala e dëmtuar duke paditur çdo person fizik/juridik që konsideron që ka shkaktuar dëmin, përfshirë këtu investitorët e HC dhe institucionet publike që kanë mundësuar realizimin e tillë në procedurat institucionale gjatë pajisjes së investuesit në HC.

⇒ **LAJMËRIMI I DËMIT, NDOTJES, DEGRADIMIT OSE SHKATËRRIMIT TË UJËRAVE DHE MJEDISIT** - Çdo person që është i njoftuar për dëmtim të mjedisit, duhet të bëjë **NJOFTIM** pranë **Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit/Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit** ose në organin tjetër përgjegjës përfshirë organet lokale. Poashtu, policia dhe zyrtarët publik të autorizuar të cilët, gjatë kohës së kryerjes së detyrës së tyre zyrtare marrin informatë për çrregullim mjedisor, duhet të njoftojnë organet e përmendura.⁹⁷ Kushdo që bën ndotjen, degradimin ose shkatërrimin e ajrit, ujit apo tokës ose shfrytëzon jashtë mase burimet natyrore, si dhe shkatërrimin e mjedisit si tërësi, apo përdorimin e resurseve natyrore pa autorizimet ligjore të dhëna nga institucionet publike të vendit (pa pëlqime, leje, autorizime, licenca, etj.), e që i referohet rasteve kur kemi të bëjmë me ndërhyrje të personave fizikë/juridikë në përdorimin e resurseve natyrore pa autorizime publike, përbën vepër penale sipas Kodit Nr. 06/L-074 - Penal të Republikës së Kosovës⁹⁸. Në këtë drejtim, personat apo organet publike mund të inicojnë **KALLËZIM PENAL**⁹⁹ sipas Kodit Nr. L-123 i Procedurës Penale¹⁰⁰ për kryerjen e veprës të ndotjes, degradimit ose shkatërrimit të ajrit, ujit apo tokës ose shfrytëzimit jashtë mase të burimeve natyrore si dhe pa posedim të autorizimeve/leje shtetërore ndaj OE, si dhe kallëzim penal ndaj zyrtarëve të institucioneve publike që kanë lëshuar akte juridike jo në përputhje me legjislacionin në fuqi.¹⁰¹

90. Shih: Neni 127 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

91. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

92. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>

93. Shih: Neni 357 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2828>

94. Organizimi i Gjykatave Themelore në Kosovë sipas kompetencës territoriale sipas Ligjit Nr. 06/L0054 për Gjykatat, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18302>, është si vijon:

1. Gjykata Themelore e Prishtinës me seli në Prishtinë vepron për territorin e Komunës së Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Glogocit dhe të Graçanicës;

2. Gjykata Themelore e Gjilanit me seli në Gjilan vepron për territorin e Komunës së Gjilanit, Kamenices, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Kllokotit dhe Vërbocit;

3. Gjykata Themelore e Prizrenit me seli në Prizren vepron për territorin e Komunës së Prizrenit, Dragashit, Suharekës dhe Mamushës;

4. Gjykata Themelore në Gjakovë me seli në Gjakovë vepron për territorin e Komunës së Gjakovës, Malishevës, dhe Rahovecit;

5. Gjykata Themelore e Pejës me seli në Pejë vepron për territorin e Komunës së Pejës, Deçanit, Junikut, Istogut dhe Klinës;

6. Gjykata Themelore e Ferizajit me seli në Ferizaj vepron për territorin e Komunës së Ferizajit, Kaçanikut, Shtimes, Shtërpçës dhe Hanit të Elezit;

7. Gjykata Themelore e Mitrovicës me seli në Mitrovicë vepron për territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Skenderajit dhe Vushtrrisë.

95. Shih: Nenet 1356-372 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve;

96. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2583>

97. Shih: Neni 39 i Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;

98. Shih: Neni 338 - Ndotja, Degradimi ose Shkatërrimi i Mjedisit, Kapitulli XXVII - Veprat Penale kundër Mjedisit, Kafshëve, Bimëve dhe objekteve kulturore i Kodit Nr. 06/L-074 - Penal të Republikës së Kosovës;

99. Neni 78-80 i Kodit Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

100. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>

101. Neni 414 dhe 416 i Kodit Nr. 06/L-074 - Penal të Republikës së Kosovës;

V. KORNIZA LIGJORE PËR HIDROCENTRALET NË KOSOVË

a) Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Në Republikën e Kosovës, pasuritë natyrore si ujërat, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, e pjesët e tjera të natyrës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë me **Kushtetutën e Republikës së Kosovës**¹⁰² dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Poashtu, populli i Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me legjislacionin e fushës respektive, mund të gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund të shkelë obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.¹⁰³

b) Marrëveshjet Ndërkombëtare

Republika e Kosovës është palë nënshkruese e **Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë**¹⁰⁴, i cili është në fuqi që nga 1 korriku 2006 dhe i njëjti e obligon Republikën e Kosovës që të zbatojë pjesë të rëndësishme të legjislacionit përkatës të BE-së (acquis) në fushat respektive, në tërësi.

Gjithashtu, Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian kanë nënshkruar **Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër**¹⁰⁵, e cila është në fuqi që nga 1 prilli 2016. Më në detaje, Neni 114 - **Energjia**, Neni 115 - **Mjedisi**, Neni 116 - **Ndryshimi Klimatik**, Neni 117 - **Mbrojtja Civile**, Neni 120 - **Administrata Publike**, që të gjithat përcaktojnë se palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në fushën e **energjisë** në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut dhe të Traktatit themelues të Komunitetit të Energjisë, në fushën e **mjedisit** dhe fillimin e përmirësimit të gjendjes mjedisore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë, në fushën e **cilësisë së ajrit dhe ujit**, si dhe **mbrojtjen e natyrës**.¹⁰⁶

c) Dokumentet Strategjike të Institucioneve Publike të Republikës së Kosovës

Në funksion të zbatimit të MSA-së, Qeveria e Republikës ka miratuar **Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit 2020-2024**¹⁰⁷. Ndërsa, **Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2036**¹⁰⁸ dhe **Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036**,¹⁰⁹ janë në fuqi.

102. Shih Neni 122 - Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore, para. 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

103. Ibid 97, para. 1 dhe 2;

104. Traktati mbi Themelimin e Komunitetit të Energjisë, Tetor 2005, shih: https://mzhe-ks.net/repository/docs/traktati_per_komunitetin_e_energji-se.pdf

105. Ligji Nr. 05/L - 069 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>

106. Ibid 6, MSA, Titulli VIII - Politikat e Bashkëpunimit;

107. Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (PKZMSA) 2020 – 2024, shih: [https://www.mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202020-2024%20Final%20\[miratuar%20nga%20Qeveria\].pdf](https://www.mei-ks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202020-2024%20Final%20[miratuar%20nga%20Qeveria].pdf)

108. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026, Mars 2017, Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, fq. 16, shih: https://mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energji-se_2017-26_-pdf

109. Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036, shih: http://knmu.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Shtetërore_e_Ujërave_shqip.pdf

d) Ligjet

Tërësia e ligjeve që rregullon fushëveprimtarinë e ndërtimit të energjisë hidrike / hidrocentraleve, përfshirë këtu fushën e mjedisit dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë, përbëhet nga një mori ligjesh, siç janë:

- Ligji Nr.05/L-081 për Energjinë;¹¹⁰
- Ligji Nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;¹¹¹
- Ligji Nr.05/L-085 për Energjinë Elektrike;¹¹²
- Ligji Nr.04/L-079 për Eficiencën e Energjisë;¹¹³
- Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës;¹¹⁴
- Ligji Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;¹¹⁵
- Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;¹¹⁶
- Ligji Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;¹¹⁷
- Ligji Nr.03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;¹¹⁸
- Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim;¹¹⁹
- Ligji për Partneritet Publiko-Privat;¹²⁰
- Ligji Nr. 04/l-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe amandamentet e tij;¹²¹
- Ligji Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore¹²²
- Ligji Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës;¹²³
- Ligji Nr.04/L-060 për Mbeturina;¹²⁴
- Ligji Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës;¹²⁵
- Ligji Nr.2004/29 për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit Nr.2003/3 për Pyjet e Kosovës;¹²⁶

110. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12689>

111. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12694>

112. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12744>

113. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18216>

114. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

115. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716>

116. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2631>

117. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>

118. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2635>

119. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2833>

120. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>

121. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

122. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2804>

123. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18917>

124. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2829>

125. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3247>

126. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3247>

- Ligji Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura¹²⁷
- Ligji Nr.04/L-086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”,¹²⁸
- Ligji Nr.04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri”.¹²⁹

e) Aktet nënligjore

- Rregullore QRK- Nr. 11/2014 për Punën e Këshillit Ndër-Ministror për Ujërat;¹³⁰
- Rregullore Nr. 03./2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës¹³¹
- Rregullore MMPH Nr. 221/2013 për Rendin e Brendshëm të Parqeve Kombëtare;¹³²
- Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.07/2017 për Leje Mjedisore;¹³³
- Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.03/2018 për Procedurat për Leje Ujore;¹³⁴
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2019 për Përcaktimin e Procedurave për Përgatitjen dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrëtimi për Kategorinë e III-të të Ndërtimeve¹³⁵
- Udhëzimi Administrativ MMPH Nr.05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore;¹³⁶
- Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për Mbikqëqyrje Inspektuese dhe Procedurën për Lëshimin e Çertifikatës së Përdorimit¹³⁷
- Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 08/2012 për Përcaktimin e Dokumenteve për Aplikacionin për Pëlqim Mjedisor sipas Llojit dhe Natyrës së Produkteve¹³⁸
- Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 16/2015 për Informim, Pjesëmarrje të Publikut dhe palëve të Interesuara në Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis¹³⁹
- Udhëzim Administrativ MZHE Nr.06/2017 për Promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme;¹⁴⁰
- Udhëzimi Administrativ MZHE Nr.05/2017 për Caqet e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme;¹⁴¹

127. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2529>

128. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2865>

129. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2866>

130. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10372>

131. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9916>

132. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8930>

133. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14821>

134. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17824>

135. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21118>

136. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13027>

137. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14820>

138. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8174>

139. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11676>

140. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14964>

141. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=14893>

VI. KORNIZA INSTITUCIONALE DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE MBI NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË

Institucionet kyçe që gëzojnë autorizime në menaxhimin e ujërave dhe përdorimin e burimeve ujore në funksion të të mirave publike apo të mirave të personave juridik dhe që merren me zhvillimin e hidrocentraleve në Kosovë, janë institucionet qendrore dhe lokale, si vijon:

⇒ **MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT (MEA)** / ish **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)**, ka përgjegjësitë dhe autorizimet publike për fushën e energjisë, mbrojtjen e ambientit, ujërave, planifikimit hapësinor.¹⁴² Poashtu, siguron zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe Planin Kombëtar për Eficiencë të Energjisë dhe monitoron Planet Komunale për Eficiencë të Energjisë.¹⁴³ E njëjta, mbikëqyr dhe konstaton gjendjen e ambientit, në veçanti ndikimin e veprimtarisë industriale, të shërbimeve publike dhe të veprimtarisë ekonomike, meqë edhe këto ndërlidhen me mbrojtjen e ambientit.¹⁴⁴

- **AUTORITETI RAJONAL I PELLGJEVE LUMORE** - Funksionon në kuadër të Ministrisë kompetente (ish MMPH tani MEA) si organ i pavarur për qëllime të administrimit të ujërave, dhe ka përgjegjësinë për sigurimin e sasisë së mjaftueshme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore të një cilësie të mirë, ashtu siç nevojitet për një përdorim të qëndrueshëm, të baraspeshuar dhe të barabartë të ujit. I njëjti është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të resurseve ujore të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social-ekonomik të Republikës së Kosovës.¹⁴⁵
- **INSTITUTI I KOSOVËS PËR UJËRA** - Është paraparë si organ i pavarur përbrenda Ministrisë kompetente (ish MMPH tani MEA), dhe shërben për qëllime të zhvillimit dhe përparimit hulumtues dhe projektues.¹⁴⁶ Por, ky institut ende nuk është themeluar, dhe i njëjti ekziston vetëm në ligj.
- **AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS** - Është institucion qeveritar dhe angazhohet që përmes monitorimit të integruar të mjedisit, sistemit efikas të informimit mjedisor dhe raportimit të vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit, të ruajë kualitetin e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, të promovojë shfrytëzimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore me qëllim që të sigurojë një mjedis të shëndetshëm për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme në harmoni me progresin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale.¹⁴⁷
- **INSTITUTI I KOSOVËS PËR MBROJTJEN E NATYRËS - Sektori për Zonat e Mbrojtura dhe Menaxhimin e Monumenteve të Natyrës** - Vepron në kuadër të Ministrisë/Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë, dhe kryen punët profesionale për mbrojtjen e natyrës për Republikën e Kosovës, si dhe mban kadastrën e ekosistemeve dhe bashkërisht me personin i cili menaxhon me të mirën e natyrës e përcjell gjendjen - monitorimin e ekosistemeve të veçanta dhe të kërcënuara.¹⁴⁸ I njëjti, bën monitorimin e përhershëm të zonave të mbrojtura të natyrës.¹⁴⁹

142. Neni 2, Shtojca 9 e Rregullores (QRK) - nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29389>

143. Ibid 137, Neni 2, para. 6;

144. Ibid 137, Neni 2, para. 13;

145. Shih Neni 21 dhe 22 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;

146. Shih Neni 20. para 1 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;

147. Neni 9. para 1 i Rregullores Nr. 03./2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

148. Neni 46, para. 2. i Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës;

149. Ibid 27, Neni 9, para.1, pika 2;

⇒ **INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS** - Sektori për Hidrologji dhe Monitorimin e Ujërave, bën monitorimin hidrometrik dhe të cilësisë së ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të Kosovës.¹⁵⁰

⇒ **DREJTORATET E AGJENCISË PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**, siç janë:

- **DREJTORATI PËR ADMINISTRIMIN E PARKUT KOMBËTAR “SHARRI”**- bën hartimin e planeve të menaxhimit dhe projekteve për mbrojtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin racional të resurserve natyrore të Parkut Kombëtar “Sharri” si dhe ka për detyrë të kujdeset ndaj resurseve natyrore të Parkut Kombëtar dhe ndalimin e veprimeve ilegale, prerjet e pyjeve, gjuetinë, peshkimin, ndërtimin e objekteve dhe uzurpimin e pronave në të.¹⁵¹
- **DREJTORATI PËR ADMINISTRIMIN E PARKUT KOMBËTAR “BJESHKËT E NEMUNA”**- Kryen aktivitetet për planifikimin, ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurserve pyjore, si dhe aktivitete kontrolli dhe parandalimi të veprimeve ilegale në park.¹⁵²
- **DREJTORIA PËR GJENDJEN E MJEDISIT /SEKTORI I UJIT DHE DHEUT** - Është përgjegjëse për vlerësimin dhe analizimin e gjendjes së dheut, ujërave sipërfaqësorë, nëntokësorë, uëjrave për larje, si dhe gjendjes së ujërave dhe ndikimit të shkarkimeve në ujë.¹⁵³

⇒ **ZYRA E RREGULLATORIT TË ENERGJISË NË KOSOVË** - Rregullatori certifikon prejardhjen e energjisë të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë.¹⁵⁴ Rregullatori merr parasysh të gjitha politikat, udhëzimet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me prodhimin e energjisë nga burime të ripërtërishme.¹⁵⁵ ZRRE është kompetente për vlerësimin e kërkesave për ndërtimin e hidrocentraleve si dhe lëshimin e licencave për prodhimin e energjisë elektrike nga HC.¹⁵⁶ Vlen të theksohet se aktivitetet e energjisë për të cilat nuk kërkohet licencë është gjenerimi i energjisë elektrike në lokacion energjetik me kapacitet total që nuk tejkalon 5 MW.¹⁵⁷

⇒ **NDËRMARRJET E ENERGJISË ELEKTRIKE** përfshijnë personin fizik apo juridik që kryen një apo më shumë veprimtari të licencuara të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, tregut të organizuar të energjisë elektrike dhe është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike ose të mirëmbajtjes që ndërlidhen me veprimtaritë e cekura, por nuk përfshinë konsumatorin final.¹⁵⁸ Gjithashtu, ndërmarrja e energjisë, e cila ka licencë për transmetimin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, përfshirë Operatorin e Sistemit të Transmetimit nuk mund të marrë licencë për prodhimin apo furnizimin e energjisë elektrike, apo për prodhimin e energjisë termike.¹⁵⁹ Ndërsa, ndërmarrja e energjisë e cila ka licencë për furnizim të garantuar të energjisë elektrike nuk mund të aplikojë apo të bartë licencë për prodhim apo operim të sistemit të transmetimit të energjisë

150. Shih Neni 12, para 1 i Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;

151. Shih Neni 19 i Rregullores Nr. 03./2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

152. Shih Neni 21 i Rregullores Nr. 03./2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

153. Shih Neni 22 dhe 23 i Rregullores Nr. 03./2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;

154. Shih Neni 1, para. 6 i Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;

155. Shih Neni 38, para 2. i Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë;

156. Rregulla për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, Neni 3, para.1. Shih: http://ero-ks.org/2017/Rregullat/2017.01.17_RREGULLA%20PER%20LICENCIMIN%20E%20AKTIVITETEVE%20TE%20ENERGJISE%20NE%20KOSOVE.pdf

157. Neni 3, para. 2 i Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;

158. Shih Neni 3, para. 1, pika. 46. i Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike;

159. Shih Neni 35, para. 2. i Ligjit Nr. 04/L-079 për Eficiencën e Energjisë;

elektrike.¹⁶⁰ Ndërmarrjet kryesore energjetike në Kosovë janë Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.), Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a.), dhe ngrohtoret e qyteteve.

⇒ **KOMUNAT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS** kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, përsa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm në ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, si dhe menaxhimin e mbeturinave.¹⁶¹

160. Shih Neni 35, para. 4. i Ligjit Nr. 04/L-079 për Eficiencën e Energjisë;

161. Neni 17 dhe 18 i Ligjit Nr. 03/l-040 për Vetëqeverisjen Lokale, shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2ë30>

VII. PËRFUNDIME

1. Programi për Monitorimin e Ujërave për 40 vjet, Strategjia për Energji për 20 vjet, Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë për 10 vjet, Strategjia për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Mjedisit për 20 vjet, Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës për 20 vjet, etj, që të gjitha këto nuk kalojnë periudhën e planifikimit mbi 20 vjet. Ndërsa, lejet për ndërtimin e HC janë për një periudhe prej 40 vitesh, ky dallim i madh kohor ndërmjet tyre në planifikimet e politikave publike dhe lejet për investime dhe operim të HC në Kosovë, paraqesin **një planifikim asimetrik të politikave publike mbi sektorin e menaxhimit të resurseve ujore**. Kjo diferencë natyrshëm përcjell planifikime jo të duhura publike të pa konsoliduara ndërmjet vete.
2. **Lëshimi i lejeve ujore për ndërtimin e HC në bazë të një studimi të bërë në vitin 1983 nga MEA. Ky veprim është shumë i dëmshëm dhe studimi është jo real me gjendjen dhe rrethanat aktuale të ujërave në Kosovë.** Ndryshimet të cilat kanë ndodhur në vend që nga ajo kohë janë të shumta:
 - a) periudha kohore mbi 30 vjet është shumë e gjatë dhe pothuajse e palogjikshme që vlerësimet e këtij studimi të jenë të sakta dhe adekuate për të lëshuar leje ujore në vitin 2020;
 - b) Bombardimet e ndryshme në vende të ndryshme të Kosovës, domosdoshmërisht kanë shkaktuar deformime në natyrë dhe relievin e tokës dhe rrjedhave ujore, ndryshimin e shtratit të pellgjeve ujore dhe rrjedhave të ujit;
3. Që nga periudha e pasluftës të vitit 1999, në Kosovë janë bërë ndërtime të shumta, herë pa leje dhe pa vlerësime korrekte mbi të drejtën e ndërtimit në vend të duhur, të cilat si pasojë në mënyrë të padiskutueshme kanë ndikuar edhe në ujëra dhe pellgjet ujore.
4. Të gjitha kërkesat e OE për marrjen e përlqimeve dhe lejeve (ujore, mjedisore, ndërtimit, etj) për prodhimin e energjisë elektrike dhe lëshimi i licencave për prodhimin e energjisë elektrike, që të gjitha janë lëshuar në kundërshtim me **Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës** dhe duhet të ndërmerren masat ndëshkimore ndaj personave përgjegjës, ngase ky ligj kërkon që përdorimi i resurseve ujore për qëllime ekonomike të prodhimit të energjisë elektrike të bëhet vetëm me koncesion.
5. **Mungesa e themelimit të Institutit të Kosovës për Ujëra**, si organ i pavarur, që do të duhej të shërbejë me qëllim të zhvillimit dhe përparimit hulumtues dhe projektues, paraqet mungesë të madhe mbi planifikimin publik të projektimit mbi ujërat, monitorimin, mbrojtjen, menaxhimin dhe përdorimin e mirëfilltë të resurseve ujore me rastin e ndërtimit të HC në Kosovë.¹⁶²
6. Bazuar në të dhënat e ndërtimit të HC-ve dhe OE të tyre, Kosova po shkon drejt një situatë të **monopolit të disa OE të prodhimit të energjisë elektrike në disa regjione duke u mundësuar atyre pozitë dominuese**. Pasi që nga të dhënat rezulton se aktualisht OE e njejta janë duke ndërtuar 3 HC me shumë në rajonet e njejta, siç janë OE MATKOS Group, KELKOS Energy, Hydro Line, etj.

¹⁶² Edhe pse nuk domethënë medeomos që nëse themelohet ky Institut, ujërat do të mbrohen. Kjo ngase kemi Institut të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe natyra nuk ka mbetur aq e mbrojtur. Komentues të ndryshëm që KOSID ka intervistuar për këtë analizë kanë theksuar që ka tendencë që Instituti i Kosovës për Ujëra të themelohet për përdoret për të rehatuar e punësuar militantë politikë.

7. **OE po praktikojnë më shumë dhe kanë përzgjedhur kryesisht metodën e ndërtimit të dy e më shumë HC nga burimi i njëjtë ujqor, por me kapacitete më të vogla dhe atë nën 5 MW.** Pra, për të mos iu nënshtruar procedurave për leje mjedisore për HC mbi 5MW, OE kanë zgjedhur mënyrën e ndërtimit të HC me kapacitete më të vogla, për t'iu shmangur procedurës së pajisjes me leje mjedisore. Në këtë drejtim, institucionet publike duhet ri-vlerësuar këtë dukuri, si dhe vlerësimi i rrethanave dhe kushteve për ndërtimin e HC të bëhet në mënyrë kumulative, përfshirë këtu edhe ekzistimin e HC tjera në rrethinë të cilat furnizohen nga burimi i njëjtë ujqor, pasi që situata në fund përfundon me shterrimin apo zvogëlimin e rrjedhës ujqore në lumenj.
8. Vlerësimi ku bëhen matjet e kapaciteteve ujqore, me rastin e lëshimit të dokumenteve publike për lejimin e HC, nuk po bëhet në mënyrë të vazhdueshme me matje të kohës reale dhe parametrave të përcaktuar se sa duhet të jetë vlera e kapacitetit të mbetur ujqor kur funksionon HC. Pra, mostra e ujërave në lum është e detyrueshme dhe duhet të bëhet matja e prurjeve, në mënyrë që të bëhet vlerësimi i drejtë i kapaciteteve gjeneruese për prodhim të ujqit, ashtu që të mos cënohen nevojat e furnizimit të banorëve dhe natyrës me ujë të mjaftueshëm. Andaj, **mosvlerësimi i kapaciteteve ujqore përmes monitorimit të ujqit në kohë reale, e cila përfshin të gjitha ndryshimet klimatike, sezonale, etj, na shpjen në të dhëna jo të sakta dhe për t'u vlerësuar drejt lënda nga institucionet publike me rastin e lëshimit të pëlqimit dhe lejeve ujqore për ndërtimin e HC.** E kjo kontribuon në keqmenaxhim dhe përdorimit jo të mirëfilltë të resurseve ujqore në vend.
9. Bazuar në **Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë Elektrikë në Kosovë të ZRRE-së**, OE/ndërmarrjeve po u mundësohet jashtëligjshëm aplikimi për pajisje me licencë pa e poseduar Lejen Mjedisore por vetëm me Pëlqim Mjedisor për rastin e licencave të përkohshme, deri në sigurimin e Lejes Mjedisore brenda vitit për t'u pajisur me licencë të përhershme. Një tolerim i tillë ligjor i **ZRRE-së shkon përtej parimit të proporcionalitetit** me masën e lartë të rrezikut përmes vurrjes në disponim dhe përdorim të resurseve ujqore të vendit HC pa u siguruar Leja Mjedisore nga HC, i cili është dokumenti kryesor që vërteton vlerësimin e mirëfilltë të resurseve ujqore, aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe të mbrojtjes së të drejtave të palëve të afektuara sipas raportit të VNM-së.
10. ZRRE po e bën lejimin e hyrjes në investime të mëdha të OE për 40 vjet me ndikim të madhë socio-ekonomik e mjedisor, duke mos u siguruar Leja Mjedisore. Me këto veprime, ZRRE po e **prejudikon marrjen e lejes mjedisore të OE nga MEA.** Ndërsa, me rastin e mos-lëshimit të Lejes Mjedisore për OE nga MEA, paraqet rreziqe të mëdha të parashtrimit të kërkesave për OE për kompensim mbi investimin e HC, degradimin e ujërave dhe mjedisit, si dhe mos-rikthimin në gjendjen e mëparshme të ujërave dhe mjedisit. Andaj, resurset ujqore po vihen në dispozicion për OE nga ZRRE duke i favorizuar ata e në dëm të interesit publik.
11. **ZRRE ka vepruar me standarde të dyfishta**, në disa raste lëshon licencë të përhershme për OE për prodhimin e energjisë elektrike pa e poseduar Lejen Mjedisore, si dhe ua ka mundësuar të dërgojnë atë më pas (shih: Licenca e HC Lepenci 3 Nr. ZRRE/Li_63/20 datë 03.07.2020), ndërsa në disa raste lëshon licencë të përkohshme për OE për prodhimin e Energjisë Elektrike duke i kushtëzuar që brenda 12 muajve të sigurohet dhe dërgojet Leja Mjedisore në ZRRE (Shih: Licenca e HC Lumbardhi II Nr. ZRRE/Li_64/18, Licenca e HC Deçani Nr. ZRRE/Li_49/16, dhe Licenca e HC Belaje Nr. ZRRE/Li_50/16, që të trija të lëshuara më 03.07.2020). Një praktikë e tillë lë hapësirë për dyshime për korrupsion.

12. Korniza ligjore për HC përbëhet nga shumë akte ligjore, të cilat në përmbajtjen e tyre, kanë mos-përputhje, mbi-vendosje. Një pjesë e saj ende nuk është miratuar, e që të gjitha këto përbëjnë hapësira ligjore që kontribuojnë në këto parregullësi mbi ndërtimin e HC. **Mos-përfshirja e Ministrisë përgjegjëse dhe Komunës në secilën fazë të vlerësimit dhe lëshimit të të gjitha pëlqimeve dhe lejeve për të gjitha kategoritë e HC pa bërë dallime mbi bazën e kapacitetit të prodhimit të energjisë elektrike**, në mënyrë që veprimet e tyre të jenë në koordinim me politikën e përbashkëta publike, planifikimet publike, kjo krijon një hapësirë e mundësi të vazhdueshme për lëshimin e akteve juridike nga institucionet publike, duke mos qenë në përputhje të plotë me tërë legjislacionin në fuqi dhe manipulim nga OE.
13. Protestat e qytetarëve me rastin e ndërtimit të HC në Kosovë, dëshmojnë se **nuk po zbatohet legjislacioni në fuqi** nga institucionet publike të vendit dhe OE, posaçërisht nuk po bëhet zbatim i kritereve ligjore me rastin e lëshimit të **lejeve ujore, mjedisore dhe ato të ndërtimit**.
14. **ZRRE nuk ka zbatuar të gjitha kriteret ligjore me rastin e lëshimit të licencave për OE për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE/ujëra**, në veçanti, duke anashkaluar mungesën e posedimit të lejeve mjedisore nga OE.

VIII. REKOMANDIME

⇒ Për institucionet publike:

1. Të bëhet **një studim i ri i detajuar mbi gjendjen e resurseve ujore/ujërave** në Kosovë, i cili prezenton të dhënat e fundit dhe të sakta mbi gjendjen e ujërave dhe largimin e referimit të vlerësimit të resurseve ujore sipas studimit të vitit 1983;
2. Bazuar në studimin e ri të resurseve ujore, të bëhet **një raport vlerësues mbi kapacitetet gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE, si dhe mundësitë për investim të ndërmarrjeve** në vendet e përshtatshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, e gjithë kjo në bazë të dhënave të vlerësimit të ri mbi gjendjen e ujërave në Kosovë;
3. Të publikohet **një raport vlerësues zyrtar nga institucionet publike mbi gjendjen e resurseve ujore në Kosovë dhe mundësitë e ndërtimit** (me të dhëna statistikore të sakta mbi kapacitetin e ujërave në secilin regjion gjeografik si dhe mundësitë e ndërtimit sipas vendit), ku që të gjitha institucionet publike të vendit t’i referohen të dhënave të njëjta gjatë planifikimit dhe menaxhimit të punëve që ndërlidhet me ujërat;
4. Të ndërmerret masat ligjore për ndalimin e praktikës së shkeljes dhe mos-zbatimit të **Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës** dhe masat ndëshkimore ndaj personave përgjegjës, ngase ky ligj kërkon që përdorimi i resurseve ujore për qëllime ekonomike të prodhimit të energjisë elektrike të bëhet vetëm me koncesion;
5. Të merret **vendimi i ri nga KNMU dhe nga ZRRE-së për trajtimin e “aplikimeve të reja” për pajisje me dokumente mbështetëse për dhënien e lejeve dhe licencave për prodhim të energjisë elektrike nga BRE/ujore** mbi bazën e studimit dhe raportit të ri zyrtar të ujërave, i cili do të përdoret si dokument referencues mbi planifikimet për shfrytëzimin e resurseve ujore për prodhim të energjisë elektrike.
6. Të ngritet **angazhimi, kontributi dhe vizibiliteti i punës së Këshillit Ndër-Mministror për Ujërat**, në mënyrë që të sigurojnë konsolidimin e punëve të organeve qëveritare mbi politikatat publike të ujërave.
7. Të bëhet **ndalimi i aplikimeve të reja të përdorimit të resurseve ujore për qëllime komerciale në Kosovë dhe të mos bëhet vazhdimi i lëshimit të Lejeve Ujore dhe Lejeve Mjedisore deri në sigurimin e vlerësimeve të reja, të bëra në nivel vendi sipas studimit dhe raportit të ri**, ashtu që lejet vijuese të jenë në përputhje me raportin dhe të siguri përdorimi i mirëfilltë i resurseve ligjore dhe në pajtueshmëri të plotë me tërë kornizën ligjore të vendit.
8. Të **rivlerësohen të gjitha autorizimet preliminare, finale dhe licencat ekzistuese të OE për ndërtimin dhe funksionimin e HC në Kosovë, në bazë të rezultateve të reja të studimit, si dhe të vendosen kërkesat shtesë për ndërprerje apo modifikim të tyre sipas specifikacioneve të tyre që rezultojnë në krahasim me vlerësimin/raportin e ri të ujërave.**
9. Meqë Kosova është vend i vogël, dhe mundësinë e vetme të furnizimit me ujë i ka nga akumulimet ujore, me rastin e ndërtimit të HC në Kosovë, **të kërkohet të bëhet Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe rrjedhimisht lëshimi i Lejes Ujore dhe Mjedisore për HC që fillojnë prej 2 MW**

e sipër të prodhimit të energjisë elektrike, sikurse një mesatare e vendeve të rajonit si Bosnja dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Serbia, etj.¹⁶³

10. Të rishikohet legjislacioni përkatës dhe të bëhet plotësim-ndryshimi i tij që rregullon veprimtarinë e HC për të adresuar çështjet si:
 - a) përcaktimi i kriterëve kufizuese përkatëse për **mos-lejimin e krijimit të pozitës dominuese të OE në prodhimin e energjisë elektrike** nga energjia hidrike;
 - b) kriteret e precizuara për lëshimin e **lejes ujore, lejes së ndërtimit, lejes mjedisore**, si dhe **licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE/ujore**, të përfshihen në ligjet bazë, duke mos lejuar institucionet publike individualisht të zbusin kriteret në baza vetanake apo duke i ndryshuar ato përmes akteve nënligjore (rregullore, udhëzime administrative, vendime, etj.), si dhe ZRRE-së.
11. Të bëhet përfshirja e nivelit komunal (komunat) dhe qendror (ministrisë) bashkërisht në çdo fazë me rastin e lëshimit të akteve juridike (leje ujore, mjedisore, ndërtimi, etj) të HC për secilin aplikim të lejeve mjedisore, pa marrë parasysh kapacitetin prodhues të tyre, dhe një gjë e tillë të përfshihet në ligje, e jo të mbeten që të rregullohen me akte nënligjore. Një gjë e tillë po mundëson që ndërrimet e qeverive/kabinetit qeveritar, të ndryshojnë këto akte nënligjore sipas interesave të individëve/grupeve të caktuara dhe jo interesit publik në tërësi.
12. Me rastin e lëshimit të lejeve mjedisore, të rishikohen e të plotësohen kriteret për lëshimin e lejes mjedisore ashtu që të bëhet **vlerësimi kumulativ i të gjitha kushteve ujore e mjedisore** me rastin e vlerësimit për lëshimin e lejeve mjedisore për OE, **duke zgjeruar perimetrin e vlerësimit të ndikimit**, si dhe marrë për bazë ekzistimin e HC të tjera që kyçen në burimet e njejta ujore dhe ndikimin e tyre në tërësi.
13. Të themelohet sipas nevojës dhe vlerësimeve të dala nga Komisioni Hetimor Parlamentar për Procesin e Licencimit, Operimit, Mbikëqyrjes dhe Operimit për Leje të Hidrocentraleve, një **task-forcë për mbrojtjen e resurseve natyrore**, e cila të koordinojë punët për monitorimin e vendit dhe përdorimin e resurseve ujore në koordinim dhe bashkëpunim, parandalimin e dukurive të ndërtimit të HC.
14. Meqë raportet e përpiluara deri më tani nga personat juridikë të licencuar nga MEA (ish-MMPH) po rezultojnë se nuk janë përpiluar dhe kompletuar me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi, atëherë duhet të bëhet **rivlerësimi i raporteve të VNM-ve, të bëhet rivlerësimi i personave juridikë të licencuar për përpilimin e raporteve të VNM-së¹⁶⁴ e sipas nevojës** të bëhet edhe ri-licencimi i tyre sipas një procedure transparente dhe në baza meritore.
15. Të krijohet një mekanizëm monitorues dhe kontrollues në kuadër të institucioneve publike, i cili bën verifikimin dhe sigurimin e zbatimit të plotë të gjitha kriterëve ligjore me rastin e përpilimit të raporteve të VNM-ve nga ana e të licencuarve/personave juridikë.

163. Policy Guidelines by the Energy Community Secretariat on Small Hydropower Projects in the Energy Community, 4.6. Overview of the Regulatory Scope of Small Hydropower Plants in the Contracting Parties pg. 31, shih: https://cdn.fsbx.com/v/t59.2708-21/120114202_629450844436642_8479941373002951294_n.pdf/Annex-1-Policy-Guidelines-on-small-hydropower-projects-in-the-Energy-Community.pdf?nc_cat=108&nc_sid=0cab14&nc_ohc=Q4hEhtcv8TAAX9zSXrd&nc_ht=cdn.fsbx.com&oh=ea53a

164. Lista e personave juridikë të licencuar për përpilimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për hidrocentralet, shih: [https://mmpH.rks.gov.net/assets/cms/uploads/files/Leje%2CLicensa%2CPelqimet/Lista_personave_juridikë_të_licencuar_për_hartimin_e_Raportit_për_Vlerësimin_e_Ndikimit_në_Mjedis_\(VNM\)_146420.pdf](https://mmpH.rks.gov.net/assets/cms/uploads/files/Leje%2CLicensa%2CPelqimet/Lista_personave_juridikë_të_licencuar_për_hartimin_e_Raportit_për_Vlerësimin_e_Ndikimit_në_Mjedis_(VNM)_146420.pdf)

⇒ Për qytetarët, shoqërinë civile dhe palët e interesit:

1. Të angazhohen në mënyrë aktive në realizimin e të drejtave të tyre, përmes mjeteve juridike (ankesa, padi, kallxime penale, etj), sipas mundësive dhe rrethanave të rastit. Për secilën fazë, udhëzimet dhe mjetet juridike që duhet ndërmarrë qytetarët/komuniteti janë të përshkruara në pikën IV të këtij raporti. (*Realizimi i të drejtave ligjore të komunitit në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe mbrojtjen e mjedisit*);
2. Të ndërmarrin veprime të menjëhershme kurdo që posedojnë të dhëna mbi ndërtimet e HC, duke kërkuar qasje në dokumentet mbështetëse të HC, për t'u informuar drejt, si dhe për të adresuar çështjet ligjore brenda afateve ligjore;
3. Të bashkëpunojnë ngusht me mediat dhe shoqërinë civile në ngritjen e shqetësimeve, ankesave dhe kërkesave të tyre në të gjitha nivelet shtetërore;
4. Të inicojnë peticione, varësisht sipas rrethanave dhe mundësive, sipas procedurave të legjislacionit për peticione dhe dërgimin e tyre pranë institucioneve publike kompetente;
5. Të bashkohen në mes vete të gjitha OJQ-të dhe mediat në nivel vendi për ngritjen e zërit, reagimit të shpejtë, si dhe përfaqësimit sa më të mirë dhe të madhë në numër, me qëllim të një krijimi të **një task-force të komunitetit në mbrojtjen e resurseve ujore dhe mjedisit**;
6. Të jenë fizikisht prezentë para institucioneve përkatëse kur informohen për marrjen e vendimeve të rëndësishme siç janë zgjatjet e lejeve, sigurimin e pëlqimeve mjedisore etj duke kërkuar monitorim të këtyre mbledhjeve dhe duke siguruar karrikë në dhomën ku vendoset për resurset natyrore e ujore që ata i shfrytëzojnë.

IX. SHTOJCAT

SHTOJCA I. LISTA E LICENCAVE DHE AUTORIZIMEVE TË LËSHUARA NGA ZRRE PËR HIDROCENTRALET NË KOSOVË

⇒ Lincencat e lëshuara për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga BRE (uji)

| Nr. | Emri i Nëmarrjes | Emri i Pronarit dhe Kontaktet: | Nr. i Licencës dhe Nr. i Vendimit | Data e Lëshimit | Lloji i Licencës | HC | Regjioni/Lokacioni | Kapaciteti për MW |
|---|---|--|------------------------------------|-------------------|--------------------------|--------------------|---------------------------|-------------------|
| 1. | Hidroenergji Sh.P.K. | 1. Ragip Zymberi 2. Zeqir Shamolli 3. Nderim Rexha 4. Valon Ademi, Fisnik Dragusha, 5. Jon Arifi - P.A. Tel: 044-660-185, email: nderimrexha@gmail.com | ZRRE/ Li_63/20 & V_1267_2020 | 03 Korrik 2020 | Përherëshme (40 vjet) | HC Lepenci 3 | Sllatinë, K. Kaçanikut | 9,98 MW |
| 2. | Kelkos Energy Sh.P.K. - HC Lumbardhi II | 1. George Leopold Wober, 2. Ingo Preiss, 3. Martin Pieter Dolzer Tel: +38338717729; E-mail: office@kelkos.com | ZRRE/ Li_64/18 & V_1182_2019 | 14 Tetor 2019 | Përkohshme (12 muaj) | HC Lumbardhi II | Deçan, ZK. Deçanit | 6, 2 MW |
| 3. | Kelkos Energy Sh.P.K. - HC Deçani | 1. George Leopold Wober, 2. Ingo Preiss, 3. Martin Pieter Dolzer Tel: +38338717729; E-mail: office@kelkos-decan.net | ZRRE/ Li_49/16 & V_1184_2019 | 14 Tetor 2019 | Përkohshme (12 muaj) | HC Deçani | Deçan, ZK. Deçanit | 9, 8 MW |
| 4. | Kelkos Energy Sh.P.K. - HC Belaje | 1. George Leopold Wober, 2. Ingo Preiss, 3. Martin Pieter Dolzer Tel: +38338717729; E-mail: office@kelkos-decan.net | ZRRE/ Li_50/16 & V_1183_2019 | 14 Tetor 2019 | Përkohshme (12 muaj) | HC Belaje | Deçan, ZK. Deçanit | 8.06 MW |
| Total: 4 Hidrocentrale në 2 regjione | | | | | | | | 34,04 MW |

⇒ **Autorizimet Finale për Ndërtimin e HC për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga BRE (uji)**^[1]

| Nr. | Emri i Ndërmarrjes | Emri i Pronarit dhe Kontaktet: | Nr. i Vendimit | Data e Lëshimit | Autorizimi Final për Periudhë / Afati i V1. | HC | Regjioni / Lokacioni | Kapaciteti për MW |
|-----|-----------------------------------|--|----------------|-----------------|---|----------------|--|-------------------|
| 1. | Eurokos JH SH.P.K. | 1. N.P.T. Al-Vis 2. Arbresha Ademi Rruqi, 3. Fehmi Cakiqi, P.A. Tel: +383 44 220 362; | V_1243_2020 | 06.04.2020 | 1 vit, vlen deri më 09.02.2021 | HC Restelica 3 | ZK Krushevë & Gllloboqic, K. Dragash | 2.35 MW |
| 2. | Eurokos JH, SH.P.K. | 1. Yll Shamolli, 2. Yllka Saraçi, 3. Ylber Shamolli, 4. Jalldyze Shamolli, Tel: +383 45 600 595; | V_1242_2020 | 06.04.2020 | 1 vit, vlen deri më 09.02.2021 | HC Brodi 1 | Brod, ZK Brod, K. Dragashit | 2.48 MW |
| 3. | NPN Renelual Tahiri SH.P.K. | 1. Ali Hoxha, 2. Lulzim Hoxha, 3. Nebi Hoxha, 4. Refki Hoxhaj (Pronar & P.A./Drejtor); | V_1241_2020 | 06.04.2020 | 1 vit, vlen deri më 29.03.2021 | HC Dragash | ZK Radesh, Plavë dhe Rapçe, K. Dragashit | 3.4 MW |
| 4. | Hydro-Line, SH.P.K. | 1. Termo Cosing, 2. Nuha Baunternehmung gmbh & co.kg, 3. Muhamer Ibrahimimi (Pronar dhe P.A.) Tel: +383 44 600 505; | V_1229_2020 | 12.02.2020 | 1 vit / vlen deri më 27.02.2021 | HC Albaniku 4 | ZK Selac dhe Vidishiq, K. Mitrovicës | 1.119 MW |
| 5. | Hydro-Line, SH.P.K. | 1. Termo Cosing, 2. Nuha Baunternehmung gmbh & co.kg, 3. Muhamer Ibrahimimi (Pronar dhe P.A.) Tel: +383 44 600 505; | V_1228_2020 | 12 .02.2020 | 1 vit / vlen deri më 27.02.2021 | HC Albaniku 1 | ZK Vllahi, K. Mitrovicës | 1.868 MW |
| 6. | Matkos Group HC Shtërpce, SH.P.K. | 1. Labinot Vitija, (P.A.), 2. IGT Corporation, j.s.c.; 3. “Karaxha Invest” sh.p.k., Tel: +383 44 900 900; | V_1226_2020 | 12 .02.2020 | 1 vit / vlen deri më 28.01.2021 | HC Shtërpce | ZK. Shtërpce K. Shtërpce, | 5.031 MW |
| 7. | Matkos Group HC Sharri, SH.P.K. | 1. MG HCE Shterpca L.L.C., 2. Labinot Vitija (Drejtor), 3. “Reinvest Group” L.L.C. Tel: +383 44 900 900; | V_1225_2020 | 12 .02.2020 | 1 vit / vlen deri më 28.01.2021 | HC Sharri | ZK Shtërpce K. Shtërpce, | 6.453 MW |
| 8. | 2 Korriku SH.P.K. | 1. Ejup Kovaçi, Tel: +383 44 113 514; | V_1224_2020 | 12 .02.2020 | 1 vit / vlen deri më 18.01.2021 | HC Soponica | ZK Doganaj, K. Kaçanik | 1.3 MW |

| | | | | | | | | |
|--|------------------------------|---|-------------|-------------|----------------------------------|---------------|---------------------------|------------------|
| 9. | Hydro-Line, SH.P.K. | 1. Termo Cosing, 2. Nuha Baunternehmung gmbh & co.kg, 3. Muhamer Ibrahimimi (Pronar dhe P.A.) Tel: +383 44 600 505; | V_1113_2019 | 28 .02.2019 | 6 muaj / vlen deri më 27.07.2019 | HC Albaniku 1 | Batahir, ZK. Mitrovicës | 3.556 MW |
| 10. | Matkos Group HC Viça SH.P.K. | 1. Labinot Vitija, 2. Alba Group, 3. MG-HCE-Shterpca, Tel: +383 44 900 900; | V_1202_2019 | 27.11.2019 | 4 muaj / vlen deri në Mars 2020 | HC Vica | ZK. Drekoc K. Shtërpce, | 4.6 MW |
| 11. | Eko-Energji Sh.P.K. | 1. Islam Hyseni, 2. Zymer Dragobuzhda, 3. Muzafer Dragobuzhda, 4. Kemajl Dragobuzhda, 5. Islam Hyseni (P.A.) Tel: +383 44 135 976; | V_1167_2019 | 10.07.2019 | 1 vit / vlen deri më 15.12.2019 | HC Binça | ZK Binça, K. Vitisë | 1 MW |
| 12. | NPN Renelual Tahiri SH.P.K. | 1. Ali Hoxha, 2. Lulzim Hoxha, 3. Nebi Hoxha, 4. Refki Hoxhaj (Pronar & P.A./Drejtor); | V_1116_2019 | 28.02.2019 | 1 vit, vlen deri më 27.02.2020 | HC Orqusha | ZK Orqushë, K. Dragash | 4 MW |
| 13. | N.N. Dilli - Com | 1. Kujtim Zena, 2. Amir Milaimi, 3. Astrit Behra, Tel.: +383 44 678897; 4. Amir Milaimi (P.A.) E-mail: amir.milaimi@outlook.com; | V_1090_2019 | 28.01.2019 | 1 vit / vlen deri më 14.12.2019 | HC Bresana | ZK Bresanë, K. Dragash | 0.31 MW |
| 14. | Hidro Forca SH.P.K. | 1. Ramiz Topojani, 2. Naim Kabashi, Tel: +491715428105 | V_986_2018 | 13.06.2018 | 2 vjet/ vlen deri më 12.06.2020 | HC Saponica 2 | ZK Saponicë, K. Kaçanik | 3 MW |
| 15. | Hydro-Line SH.P.K. | 1. Termo Cosing, 2. Nuha Baunternehmung gmbh & co.kg, 3. Muhamer Ibrahimimi (Pronar dhe P.A.) Tel: +383 44 600 505; | V_935_2018 | 29.03.2018 | 1 vit / vlen deri më 21.01.2019 | HC Albaniku 2 | ZK Batahir, K. Mitrovicës | 3.556 MW |
| Total: 15 Hidrocentrale në 6 regjione | | | | | | | | 44.023 MW |

⇒ **Autorizimet Preliminare për Ndërtimin e HC për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga BRE (uji)** [2]

| Nr. | Emri i ndërmarrjes | Emri i Pronarit dhe Kontaktet: | Nr. i Vendimit | Data e lëshimit | Autorizimi final për periudhë / afati | HC | Regjioni / Lokacioni | Kapaciteti për MW |
|---|---------------------|--|----------------|-----------------|---------------------------------------|---------------|----------------------------|-------------------|
| 1. | Dino Energy SH.P.K. | 1. Ramadan Salihu, 2. Abedin Salihu, 3. Ibrahim Salihu, Tel: +383 44 206 685; | V_1227_2020 | 12.02.2020 | 6 muaj / vlen deri më 20.06.2020 | HC Lepenci 2 | ZK Kaçanik, K. Kaçanik | 3.3 MW |
| 2. | gEnCi SH.P.K. | Ekrem Cërvadiku, Tel: +383 44 113 003; | V_938_2018 | 29.03.2018 | 6 muaj / vlen deri më 11.05.2018 | HC Prizreni 4 | ZK Jabllanicë, K. Prizren | 2.83 MW |
| 3. | gEnCi SH.P.K. | Ekrem Cërvadiku, Tel: +383 44 113 003; | V_937_2018 | 29.03.2018 | 6 muaj / vlen deri më 11.05.2018 | HC Prizreni 8 | ZK Nebregoshtë, K. Prizren | 2.1 MW |
| 4. | gEnCi SH.P.K. | Ekrem Cërvadiku, Tel: +383 44 113 003; | V_936_2018 | 29.03.2018 | 6 muaj / vlen deri më 11.05.2018 | HC Prizreni 9 | ZK Reçan, K. Prizren | 1.93 MW |
| Total: 4 Hidrocentrale në 2 regjione të ndryshme | | | | | | | | 10.16 MW |

[1] Autorizimet finale përfshijnë tërësinë e përfundimit të punimeve në ndërtimin e hidrocentraleve.

[2] Autorizimet preliminare i'u lëshohen aplikuesve/investitorëve për pajisjen e lëndës pranë institucioneve publike të vendit me dokumentet mbështetëse siç është leja e ndërtimit, etj.

SHTOJCA II - DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FUNKSIONIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË

| DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FUNKSIONIMIN E HIDROCENTRALEVE NË KOSOVË | | | | | | | | | | |
|---|---|--|---|---|---|---|--|--|---|--|
| DOKUMENTI | RAPORTI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS | PËLQIM PËR KUSHTET NDËRTIMORE | PËLQIM MJEDISOR | PËLQIM UJOR | LEJE NDËRTIMI | LEJE UJORE | LEJE MJEDISORE | LEJE MJEDISORE E INTEGRUAR | LICENCË E PËRKOHSHME E PRODHIMIT TË ENERGIJISË | LICENCË E PËRHERSHME E PRODHIMIT TË ENERGIJISË |
| QËLLIMI | Vlerësimin e ndikimeve të mundshme të projektit në njeriun dhe mjedisin (botën bimore e shtazore, tokë, ujë, ajër, klimë dhe peisazh, të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore). | Përcaktimi i termave dhe kushteve ndërtimore teknike që shërbejnë si bazë për ndërtimin e hidrocentraleve. | Parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis të veprimtarive publike dhe private. Gjithashtu, që të sigurohet përputhshmëria e projektit me planet dhe programet e institucioneve publike, që të sigurojnë shkakllë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. | Përcakton kushtet të cilat duhet të plotësohen gjatë kryerjes së punimeve, dërgimi i të dhënave në sistemin e kompensimeve të dëmeve të shkaktuara personave të tretë gjatë zhvillimit të punimeve në kohën e validitetit të pëlqimit uJOR. | Sigurimi i ndërtimit të objektivit / hidrocentralit në përputhje me Kodin e Ndërtimit, si dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor. | Administrimi, menaxhimi i integruar dhe i qëndrueshëm i ujërave për të siguruar sasi të mjaftueshme dhe cilësi të mirë për të gjithë shfrytëzuesit e ujërave. | Parandalimi dhe zvogëlimi i ndikimeve negative për mjedis të veprimtarive publike dhe private. | - Parandalimi dhe zvogëlimi i ndikimeve negative për veprimtaritë negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut me rastin e vendosjes së impianteve, posaçërisht kur kemi të bëjmë me zonat e mbrojtura të natyrës dhe vendet me interes strategjik për vendin, me rastin e lëshimit të lejes për operim. | Mundësimi i bartësit të licencës të ushtrrojë aktivitetet në sektorin e energjisë, për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve në lidhje me sektorin e energjisë. | Mundësimi i fillimit të punës së bartësit të licencës të ushtrrojë aktivitetet në sektorin e energjisë, për të cilat nevojitet licenca e përherëshme të sigurohet brenda vitit në përputhje me dispozitat e ligjeve në lidhje me sektorin e energjisë. |

| | | | | | | | | | |
|------------------|--|---|--|---|---|---|---|--|--|
| FUSHË VEPRIMI | -Ndikimi i kombinuar në mjedis me projekte ekzistuese dhe ose të ardhshme; -Përdorimi i burimeve natyrore; -Gjenerimi i mbeturinave; Ndotja dhe shqetësimi; | - Përcaktimi i termave dhe kushteve të ndërtimit që shërbejnë si bazë për ndërtimin e hidrocentralit. | - Ndikimi i projektit në mjedis; -Ndikimi në shëndetin e njeriut; | - Ndërtimi i hidrocentralit është hartuar në përputhje me kushtet ujore, legjislacionin e ujërave dhe dokumentet planifikuese për rajonin përkatës. | - Siguron se ndërtimi i objektit / hidrocentralit ruan jetën cilësore të qytetarit, ruan tokën bujqësore dhe resurset natyrore. | - Përcaktohet destinimi, mëyra dhe kushtet e shfrytëzimit të ujit, regjimi i punës së objekteve dhe pajisjeve, mënyra dhe kushtet e shkarkimit të ujërave të ndotur, mënyra dhe kushtet e largimit të mbeturinave të lëngëta dhe të ngurta dhe kushtet tjera. | -Rregullimi i sistemit të integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. | - Mbrojtja e shëndetit të njeriut; - Mbrojtja e Mjedisit; | - Prodhimin e energjisë elektrike; - Përdorimi i resurseve natyrore në përputhje me legjislacionin në fuqi. |
| | | | | | | | | | |



Botim i KOSID - Kosovar Civil Society Foundation for Sustainable Development. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga KOSID. Ky botim nuk mund të riprodhohet, nuk mund të ruhet në sisteme memorizuese, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, vetëm në tërësi, përdorimi për qëllime komerciale të këtij botimi nuk lejohet pa miratimin me shkrim nga KOSID.

Për informacion info@kosid.eu.com

Prodhimi i këtij raporti është mbështetur financiarisht nga Programi i Ujërave të ëmbla të WWF Adria.



Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare dhe pozicionin e WWF Adria

